

QËNDRUESHMËRIA EKONOMIKE E KOSOVËS



(SFIDAT, POLITIKAT
DHE MUNDËSITË)



RIINVEST
INSTITUTI PËR HULUMTIME ZHVILLIMORE
INSTITUTE FOR DEVELOPMENT RESEARCH



2



QËNDRUESHMËRIA EKONOMIKE E KOSOVËS (SFIDAT, POLITIKAT DHE MUNDËSITË)

Ky raport është përgatitur për të shërbyer si bazë për tryezën e diskutimit. Ai është mbështetur nga "Friedrich Ebert Stiftung".



Prishtinë
5 dhjetor 2005

Ekipi i projektit:

Muhamet Mustafa, udhëheqës i projektit

Isa Mustafa

Venera Demukaj

Petrit Gashi

Besnik Krasniqi

Gazmend Ahmeti

Salvador Bajrami

Durim Hoxha

Fadil Aliu

Lumir Abdixhiku

Alban Zogaj

Botues:

Instituti Riinvest

Redaktor:

Sejdi Osmani

Lektura:

Safet Zejnullahu


Design:

Elbunit F. Krasniqi

Shtypur në:

AKRONIMET DHE SHKURTESAT

AER – Agjensioni Evropian për Rindërtim
AKM – Agjencia Kosovare e Mirëbesimit
BB – Banka Botërore
BE – Bashkësia Evropiane
BEI – Banka Evropiane për Investim
BERZH – Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
CEPES – Qendra Evropiane për Arsim të Lartë
CIS – Vendet e ish-Bashkimit Sovjetik
DFID – Departamenti për Zhvillim Ndërkombëtar
EJL – Evropa Juglindore
ESK – Enti Statistikor i Kosovës
FMN – Fondi Monetar Ndërkombëtar
FPP – Faktorët e Përgjithshëm të Produktivitetit
GTZ – Agjensioni Zhvillimor i Gjermanisë
GDP – Bruto Produkti Vendor (BPV)
IFN – Institucionet Financiare Ndërkombëtare
IJD – Investimet e Jashtme Direkte
IMF – Fondi Monetar Ndërkombëtar
IPVQ – Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse
MEF – Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MTL – Marrëveshja e Tregtisë së Lirë
NP – Ndërmarrjet Publike
NSH – Ndërmarrjet Shoqërore
NVM – Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
OBT – Organizata Botërore Tregtare
OECD – Organizata Evropiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim
OKB – Organizata e Kombeve të Bashkuara
R&D – Hulumtim & Zhvillim
SDC – Korporata Zhvillimore e Zvicrës
SHBA – Shtetet e Bashkuara të Amerikës
SIDA – Agjensioni Suedez për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar
TVSH – Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
USAID – Agjensioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
UNESCO – Organizata e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kombeve të Bashkuara
UNMIK – Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë





PËRMBAJTJA

1. HYRJE	9
2. QËNDRUESHMËRIA EKONOMIKE DHE RËNDËSIA E SAJ PËR KOSOVËN.....	9
2.1. Vështrim mbi konceptet teorike dhe përvojat nga disa vende	11
2.2. Qëndrueshmëria ekonomike dhe rëndësia e saj për Kosovën.....	11
2.3. Historiku i shkurtër i rritjes ekonomike të Kosovës	14
2.4. Kushtet dhe faktorët të cilët ndikojnë / përkrahin qëndrueshmërinë ekonomike në Kosovë	15
2.4.1. Kapitali njerëzor	16
2.4.2. Niveli arsimor i popullsisë.....	17
2.4.3. Pasuritë natyrore	17
2.4.4. Investimet	18
2.4.5. Ambienti institucional dhe politikat ekonomike	21
2.4.6. Stabiliteti makroekonomik	21
2.4.7. Infrastruktura dhe shërbimet publike	23
3. SI TË KRIJOHET RRITJA EKONOMIKE	24
3.1. Nevoja për përshpejtimin e rritjes ekonomike	27
3.2. Skenarët e mundshëm të rritjes ekonomike	27
3.3. Burimet dhe potencialet e zhvillimit ekonomik	27
4. INVESTIMET PËR RRITJE EKONOMIKE DHE QËNDRUESHMËRI	30
4.1. Projektimet indikative të investimeve të nevojshme	33
4.2. Struktura potenciale e burimeve të investimeve	33
4.3 Si të krijohet një “ambient i favorshëm për investime”	33
5. DREJT NJË BUXHETI TË QËNDRUESHËM	34
5.1. Progresi deri më tash	37
5.2. Problemet dhe mungesat aktuale	37
6. PROBLEMET STRUKTURALE DHE NEVOJAT PËR BASHKËPUNIM DHE ASISTENCË TEKNIKE NDËRKOMBËTARE	43
Aneks 1: PËRMBLEDHJET E PROFILIT EKONOMIK TË KOSOVËS	45
Aneks 2: BALANCI I TREGUT TË PUNËS NË KOSOVË – 2002	47
BIBLIOGRAFIA.....	48



8



DREJT NJË QËNDRUESHMËRIE EKONOMIKE PËR KOSOVËN

1. HYRJE

Ky raport ¹ ka për qëllim të trajtojë shkurtimisht sfidat me të cilat do të përballlet Kosova në rrugën e saj drejt krijimit të një ekonomie të qëndrueshme, në kohën kur po punohet në hartimin e Planit Kombëtar Zhvillimor, si dhe kur kanë filluar negociatat për zgjidhjen e statusit politik e juridik. Objektivi kryesor është që të jepet një pasqyrë e gjendjes aktuale dhe të përvijohen prioritetet strategjike dhe politikat e nevojshme për t'u zbatuar nga qeveria dhe të përkrahura nga akterët tjerë të interesit, të cilat do të shërbejnë në krijimin e një perspektive të rritjes ekonomike të qëndrueshme.

Punimi është hartuar duke u mbështetur në studimet dhe në analizat e realizuara nga Instituti Riinvest, Raportet e BB-së, FMN-së e Shtyllës IV.



Raporti paraqet një kontribut për tryezën e rrumbullakët: Drejt një qëndrueshmërie ekonomike për Kosovën, e cila do të mbahet më 8 dhjetor 2005 dhe ku do të marrin pjesë përfaqësues të IPVQ-ve, të UNMIK-ut, si dhe të organizatave të tjera ndërkombëtare, si Banka Botërore, FMN dhe organizatat regjionale dhe bilaterale. Kjo tryezë është sponsoruar nga “Friedrich Ebert Stiftung”.

Raporti, së pari, bën prezantimin e koncepteve dhe aspekteve teorike lidhur me qëndrueshmërinë ekonomike, bazuar në teorinë dhe në përvojat e disa vendeve për ta arritur atë. Pjesa e dytë shtron burimet potenciale të rritjes ekonomike. Pjesa e tretë prezanton rritjen ekonomike të Kosovës që nga viti 1948, bën identifikimin e disa parakushteve dhe determinon potencialet për rritje. Pjesa e katërt dhe e pestë janë të natyrës indikative dhe prezantohen me qëllim të nxitjes së debatit. Pjesa e gjashtë fokusohet në menaxhimin e shpenzimeve publike, derisa pjesa e fundit potencon rëndësinë për financim të qëndrueshëm dhe mbështetje teknike, financuar nga ana e komunitetit ndërkombëtar.

Ky është versioni i parë i këtij raporti. Në bazë të komenteve nga debati, raporti do të rishikohet dhe do të përpunohet më tutje.

Falënderojmë “Friedrich Ebert Stiftung” për përkrahjen e dhënë. Të gjitha konstatimet dhe vlerësimet e dala janë pikëpamje të Institutit Riinvest dhe assesit nuk mund t'i atribuohen opinionit të akterëve të tjerë të përfshirë në Forumin 2015.

¹ Hartuar nga ekipi i Riinvestit: Muhamet Mustafa, Isa Mustafa, Venera Demukaj, Besnik Krasniqi, Gazmend Ahmeti, Salvador Elmazi, Fadil Aliu



2. QËNDRUESHMËRIA EKONOMIKE DHE RËNDËSIA E SAJ PËR KOSOVËN

2.1. Vështrim mbi konceptet teorike dhe përvojat nga disa vende

Në përgjithësi, ekonomia kombëtare konsiderohet e qëndrueshme nëse është e aftë të shfrytëzojë burimet dhe kapacitetet e saj njerëzore, financiare dhe kapitale, për gjenerimin e rritjes të vazhdueshme ekonomike dhe për sigurimin e mirëqenies së gjithë banorëve të saj. Rëndësia e resurseve (njerëzore, financiare dhe natyrore) është e pakontestueshme, mirëpo vetëm shfrytëzimi efektiv i tyre siguron një rritje të vazhdueshme ekonomike dhe mirëqenie shoqërore. Rritja është esenciale për arritjen e stabilitetit socio-ekonomik dhe zhvillimin politik të një vendi².

Rritja substanciale afatgjate do të siguronte ekonomi të qëndrueshme. Rritja ekonomike paraqet rritjen e produktit real të brendshëm bruto të një vendi dhe ndryshimin në kapacitetet prodhuese të vendit. Rritja nuk shfaqet rastësisht. Ajo është rezultat i politikave cilësore (produktivitetit, teknologjisë, risive dhe efekteve të jashtme). Zhvil-

2\ Zhvillimi i mendimit ekonomik lidhur me burimet e rritjes ekonomike është evident gjatë Luftës së Dytë Botërore. Michael Todor bën identifikimin e pesë drejtimeve kryesore:

(1) Teoria Lineare e Fazave - përvojat e Planit Marshal dhe të vendeve në zhvillim gjatë viteve 1950 kanë promovuar fazat e Roslow-it, një model i rritjes, i cili potencon se gjatë tranzicionit nga të qenit i pazhvilluar në të zhvilluar, në mënyrë që shoqëritë të bëhen të vetëqëndrueshme dhe të pjekura ekonomikisht, së pari duhet të bëjnë mobilizimin e të gjitha kursimeve vendore dhe ndërkombëtare. Nga kjo kohë e ka prejardhjen modeli i mirënjohur i investimeve për rritje të shpejtë, i mbështetur nga Harrod dhe Domar (Harrod - Domar Model).

(2) Gjatë viteve 1960, Modeli i Ndryshimeve (i njohur si modeli i Lewis) promovoi ndryshimet nga bujqësia bazike në industri të ndryshme, shërbime ekonomike dhe zona të urbanizuara. Ai përdori dy aspekte - tepricat e fuqisë punëtore në bujqësi dhe transferimin e tyre në sektorin me teknologji të avancuar dhe paga të larta. Mirëpo, kjo nuk përputhet me shumicën e rasteve në vendet në zhvillim. Në këto vende edhe zonat urbane kanë një papunësi të theksuar. Drejtimi kryesor i ndryshimeve sektoriale është: nga bujqësia në industri; akumulimi i kapitalit njerëzor dhe atij fizik; ndryshimi i kërkesave të konsumatorëve; rritja e qyteteve dhe zonave urbane; bujqve përreth qyteteve të vogla, zvogëlimi i madhësisë së familjeve dhe fokusimi në cilësinë e arsimit.

(3) Teoria e ndërvarësisë (gjatë viteve 1970) bazohet në qasjen neokoloniale dhe neomarksiste. Vendet në zhvillim mbetën të pazhvilluara, përkundër faktit se ato patën mbështetje ndërkombëtare si me teknologji ashtu edhe me financa. Ato evidentuan dështim në IJD, si dhe dështime të tregut.

(4) Kundërrevolucioni neoklasik (1980): Vë në pah se me rëndësi është oferta, politikat makroekonomike, liberalizimi i tregut, reformimi i pronës publike dhe reduktimi i rregullit nga ana e qeverisë. Arsye kryesore e zhvillimit të ulët janë alokimi i dobët i burimeve edhe ashtu të pakta, si dhe intervenimi i shtuar shtetëror. Rritja stimulohet kryesisht nga: tregu i lirë, privatizimi, tregtia e lirë dhe promovimi i eksportit, mikpritja e IJD-ve, eliminimi i çrregullimit të çmimeve.

(5) Teoria e re e pritjes (1990) / teoria endogjene: Vë në dukje se me rëndësi është sistemi i qeverisjes së procesit të prodhimit dhe jo faktorët e jashtëm. Rritja është rezultat natyror i ekuilibrit afatgjatë (M. Todor: *The Development Economics*, 2003).

limi njerëzor përfshin jo vetëm rezultatin e rritjes së GDP-së, por edhe rritjen e mundësive për qasje në edukim, shëndetësi dhe krijim të të ardhurave nga të gjithë anëtarët e shoqërisë. Në fakt, kjo mund të cilësohet si një rritje dhe zhvillim cilësor.

Procesi i rritjes ekonomike shoqërohet me një spektër të gjerë të politikave: financimin e zhvillimit, infrastrukturën publike, kornizën rregullative, politikat industriale, intervenimet qeveritare. Reformat serioze të orientuara kah ndërtimi i ekonomisë së bazuar në treg dhe krijimi i një stabiliteti ekonomik dhe politik janë faktorë kyç të rritjes në ekonominë në tranzicion.

Sfidat e vendeve në zhvillim, si pjesë e një ekonomie të përfshirë nga globalizimi dhe rritja, të fokusohen kryesisht në tejkalimin e problemeve në këto fusha:

- Kursimi, përkatësisht investimet joadekuate
- Fuqia punëtore joadekuate
- Përkeqësimi i kushteve për tregti
- Institucionet e dobëta

Në historinë më të re, rritja afatgjate ekonomike ka qenë evidente sidomos në Azinë Lindore.³ Lidhur me forcën shtytëse të këtij progresi ekzistojnë dy pikëpamje kundërtë-nëse:

- (1) Akumulimi i kapitalit së bashku me rritjen e cilësisë ishte faktor më vendimtar sesa produktiviteti i fuqisë punëtore,
- (2) Zotërimi, përkatësisht përvetësimi (nganjëherë edhe kopjimi) i teknologjive bashkëkohore.

Lidhur me kontributin e FPP (Faktorët e Përgjithshëm të Produktivitetit), i cili varet nga pjesëmarrja e kapitalit fizik në output (GDP) dhe kanaleve nëpërmjet të cilave kapitali njerëzor ndikon në prodhim, shumica e teoricienëve do të pajtoheshin se akumulimi i kapitalit është ajo forca nxitëse dhe jo FPP në rastin e Azisë Lindore. Megjithatë, si burim i rritjes në një periudhë afatgjate, FPP janë të një rëndësie të veçantë dhe shumë autorë konsiderojnë se akumulimi i kapitalit nuk ka peshë sa kanë FPP. Prandaj, kombinimi ideal bazuar në këto përvoja do të siguronte rritjen afatmesme nëpërmes akumulimit të kapitalit dhe rritjen afatgjatë nëpërmes rritjes së produktivitetit të bazuar në progresin teknologjik.

Grupi i dytë i vendeve të cilat kanë pasur mundësinë të përjetojnë një rritje të qëndrueshme afatgjatë janë vendet anëtare të OECD-së, edhe pse me një normë më të ulët në krahasim me vendet e Azisë Lindore. Megjithatë, ekzistojnë mjaft dëshmi lidhur me mundësitë reale të vendeve të varfra për një rritje të shpejtë. Në fillim të vitit 2003 OECD publikoi raportin lidhur me burimet e rritjes së vendeve anëtare të OECD-së.⁴ Në rastin e këtyre vendeve diferencat në shkallën e rritjes janë rezultat i dallimeve në shkallën e efektivitetit të fuqisë punëtore dhe në:

³ Kina dhe tigrat e tjerë: Abdul Senhadji, Shigeru, Kahu, Murat, (raportet e FMN)

⁴ (Martin Neil Billy, Institute for International Economics) OECD.

- Investimet në kapitalin fizik dhe njerëzor
- Politikat makroekonomike
- Madhësinë e aparatit qeveritar

Është konstatuar se tatimet e larta (në paga dhe fitim) dekurajojnë rritjen, ndërsa funksionimi i tregut e kapitalit ka efekt pozitiv. Gjithashtu, hapja e tregjeve dhe tregtia janë faktorë që mbështesin rritjen ekonomike.

Analiza e fundit krahasuese përmban rezultatet lidhur me “Burimet e rritjes ekonomike” nga N. Loayza (World Bank) R.Sato (Universidad Catolica Chile) dhe paraqet dëshmitë që kanë të bëjnë me përvojat e 78 vendeve nëpërmjet llogarive të gjera ekonometrike. Konkluzionet kryesore mund të përmbledhen në fushën e (a) institucioneve dhe politikave strukturore dhe (b) shkaktarëve dhe karakteristikave të rritjes ekonomike.

Sipas këtij studimi, qeveritë mund të influencojnë rritjen afatgjatë, me anë të institucioneve, politikave strukturore dhe atyre stabilizuese.

Fushat kryesore më me ndikim janë:

- (1) Arsimi dhe kapitali njerëzor, si ndikues efektivë në kategori të tjera, siç janë: kapitali fizik, adoptimi i teknologjive etj.,
- (2) Intensiteti financiar, përkatësisht zhvillimi i tregjeve financiare,
- (3) Hapja ndaj tregtisë ndërkombëtare, e cila ndikon në shkallën e konkurrencës, risive teknologjike dhe në FPP,
- (4) Kufizimet buxhetore,
- (5) Cilësia e shërbimeve dhe infrastrukturës publike,
- (6) Qeverisja (kapacitetet dhe cilësia e institucioneve, kufizimi i korrupsionit, zbatueshmëria e kontratave dhe rendi e ligji).

Lidhur me politikat industriale të cilat promovojnë sektorë specifikë, rezultatet mund të jenë shumë të pafavorshme, për shkak të çrregullimeve në treg. Nuk duhet harruar se nuk është lehtë të bëhet identifikimi i sektorëve të cilët do të jenë shtyllat kryesore të gjenerimit të rritjes. Politikat industriale mund të sigurojnë një rritje fillestare, efektet e së cilës në rritjen ekonomike do jenë afatshkurtra, në qoftë se nuk përkrahen nga të ashtuquajturat reforma të vazhdueshme.

Politikat stabilizuese kanë për qëllim krijimin e një influence dhe stabiliteti në fushën e financave, tatimeve dhe investimeve. Inflacioni i lartë dhe rreziku nga deficitin e bilancin e pagesave, i cili ka prejardhjen nga çrregullimet në kursin valutor dhe shpesh edhe nga krizat e ndryshme bankare, paraqesin pengesë serioze për rritje. Roli i sektorit financiar është kyç në kanalizimin e kursimeve në investime.

Si përfundim, mund të konstatojmë se rritja ekonomike ngrihet me përmirësimin

e edukimit, intensitetin financiar, tregtinë e hapur dhe infrastrukturën e mirë publike. Ndërsa, rritja ekonomike bie me kufizimet ekstensive, kur politikat e zbatuara nuk janë në favor të stabilitetit makroekonomik (inflacioni, stërvlerësimi i kursit valutor dhe krizat në sistemin bankar), si dhe në kushtet negative të tregtisë. Kombinimi i duhur i politikave ekonomike mund të gjenerojë modelin që siguron vetëqëndrueshmëri të rritjes ekonomike.

2.2. Qëndrueshmëria ekonomike dhe rëndësia e saj për Kosovën

A mundet Kosova të ketë ekonomi të qëndrueshme? Kjo është një pyetje e cila shtrohet shpesh, sidomos lidhur me çështjet e tjera të cilat janë të ndërlidhura me statusin përfundimtar të vendit. Natyrisht se kjo është një çështje shumë me rëndësi, e cila ka ndikim direkt në dinjitetin dhe në cilësinë e jetesës së kosovarëve. Megjithatë, sa herë që kjo shtrohet në aspektin (konotacionin) “për” ose “kundër” vullnetit të shumicës së kosovarëve, jo rrallë merr kah dhe kuptim spekulativ, sepse gjithashtu mund të shtrohet edhe pyetja se kush tjetër do të sigurojë qëndrueshmi ekonomike të vendit, në qoftë se këtë nuk e bëjnë vetë kosovarët. Faktet historike të paraqitura më poshtë dëshmojnë se rritja ekonomike e Kosovës ka qenë proporcionale me mundësinë e kosovarëve që të qeverisin vetveten, si dhe me çështjet të cilat janë shumë të ndërlidhura me stabilitetin politik. Qëndrueshmëria është diçka të cilën qeveria e ka për borxh ta sigurojë për qytetarët e saj. Në rastin e shoqërive demokratike, mospërmbyshja e kësaj detyre do të sillte fitimin apo humbjen e zgjedhjeve. Qëndrueshmëria ekonomike në kohët moderne të ndikimit të teknologjisë është më shumë e ndërlidhur me cilësinë e qeverisjes sesa me pasuritë dhe burimet natyrore. Në anën tjetër, është e qartë se, varësisht nga qëndrueshmëria ekonomike, Kosova do të bashkohej apo do të mbetej prapa shoqërive prosperuese dhe do të ishte në pozitë që të përmbushë pritjet dhe ambiciet e qytetarëve të saj. E tërë kjo çështje është më shumë e lidhur me periudhën pas finalizimit të statusit të vendit.

Nga këndvështrimi tjetër do të mund të diskutohej ndikimi i sovranitetit dhe rëndësia e tij në rritjen ekonomike. Sovraniteti dhe kontrolli i territorit, përfshirë resurset e tij natyrore, ndikon drejtpërsëdrejti në investimet afatgjata. Ai gjithashtu ka efekt edhe në marrjen e vendimeve që kanë të bëjnë me prioritetet dhe çështjet vetjake. Paqartësia politike kufizon mundësinë për alternativa, definim të rendit dhe të qeverisjes ekonomike.

Në situatën e pasluftës efektet negative të mungesës së sovranitetit janë reflektuar negativisht në shumë fusha dhe sidomos në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar me organizatat ndërkombëtare, siç janë Banka Botërore, OBT dhe organizatat tjera financiare ndërkombëtare-tregtare, si dhe në marrëdhëniet me vendet tjera, në privatizim dhe në krijimin e një klime të favorshme për IJD-të.

Pyetja e cila tani shtrohet dhe kërkon përgjigje ka të bëjë me strategjitë dhe politikat për sigurimin e burimeve për zhvillim në të ardhmen dhe për tejkalimin e pazhvillueshmërisë. Edhe më qartë kjo ka të bëjë me politikat që duhet ndjekur që Kosova të jetë një vend me prosperitet dhe i ndërlidhur me botën e zhvilluar. Para se të tentojmë të japim përgjigje në këtë pyetje, do të mundohemi që së pari të japim një pasqyrë të shkurtër lidhur me historikun e rritjes ekonomike të Kosovës, si dhe përshkrimin e gjendjes aktuale dhe sfidat me të cilat ajo mund të përballet në rrugën drejt zhvillimit dhe qëndrueshmërisë ekonomike.

2.3. Historiku i shkurtër i rritjes ekonomike së Kosovës

Shkallën më të lartë të rritjes ekonomike Kosova e ka shënuar në vitet 1965-1975, kur u bënë edhe ndryshimet thelbësore dhe cilësore në strukturën e prodhimit, si dhe rritje të moderuar gjatë viteve 1976-1980. Sistemi ekonomik dhe politik i asaj kohe ishte i decentralizuar deri në njëfarë mase, derisa pozita kushtetuese e Kosovës në sistemin ekonomik dhe politik të ish-Jugosllavisë ishte identike me njësitë tjera federative. Pas reformave

Tabela 1. Rritja ekonomike 1948-2004

Periudha	Rritja vjetore e outputit kombëtar (%)
1948-1965	5.7
1966-1970	6.0
1971-1975	7.5
1976-1980	3.6
1981-1985	1.8
1986-1988	1.1
1989-1999	-5.0
2000-2001	10-16
2002-2005	(-3) – (4)

Burimi: ESK dhe vlerësimet e IMF për periudhën e pasluftës

politike të viteve 1970, Kosova arriti pikën kur ajo u bë më e pavarur në fushën e vetëqeverisjes në politikë, ekonomi, zhvillim shoqëror, e sidomos në fushën e buxhetit, financave dhe tatimeve. Kosova aso kohe kishte të drejtë dhe fuqi që të planifikonte dhe të financonte strategjitë ekonomike dhe, në të njëjtën kohë, të hynte edhe në marrëdhënie kontraktuese me institucionet financiare ndërkombëtare. Në këtë periudhë Kosova e realizoi një rritje ekonomike të ngjashme me disa nga vendet e pasqyruara në tabelën 2. Në fillim të viteve 1980, si rezultat i krizave politike dhe ekonomike, Kosova ishte e para e cila u godit dhe gjendja u përkeqësua jashtë mase. Prodhimi vendor në periudhën 1981-1989 shënoi rritje prej 1-1.8%.

Gjatë periudhës 1989-1999 prodhimi ka pësuar rënie nga rreth \$ 700 në \$ 400 për banorë, me fjalë të tjera, gati është përgjysmuar. Pas heqjes me dhunë të Kushtetutës dhe autonomisë politike territoriale, Kosova u shndërrua në një koloni me aparteid nga ana

e pushtuesit serb. NSH dhe NP, përfshirë këtu edhe arsimin dhe institucionet kulturore, u vunë nën masat e dhunshme të regjimit të instaluar nga ana e Beogradit. Prodhimi

vendor u zvogëluar nga 10 - 30%, më shumë se 70 % e punëtorëve shqiptarë u larguan nga vendet e tyre të punës, derisa tregu pësoi një transformim nga pushtuesi, në mënyrë që të absorbojë të mirat e importuara nga Serbia dhe atë me çmime më të larta dhe me cilësi më të dobët se tregu ndërkombëtar.

Tabela 2. Rritja ekonomike e EJL dhe vendeve të tjera (%)

	1998	2001	2002	1998-2003
Armenia	7.3	9.6	12.9	7.7
Azerbajxhani	10.0	9.9	10.6	9.7
Taxhikistani	5.3	10.2	9.1	7.1
Vendet e EJL (*)	3.3	7.1	6.9	5.4
Vendet e tjera të EJL (**)	-0.2	8.1	5.8	5.1
Vendet e zhvilluara	3.5	4.1	4.6	4.5
Vendet e industrializuara	2.7	1.0	1.8	2.4

Burimi: Raporti punues i FMN-së: “Analizat e rritjeve më të hershme në vendet me të ardhura të vogla, në vendet e ish-Bashkimit Sovjetik”, 2004

Pas luftës, e cila përfundoi pas intervenimit të NATO-s, vendi ynë, bazuar në Rezolutën 1244 të OKB-së, u vu nën administrimin e UNMIK-ut. Kjo paraqet një fazë të re në zhvillimin demokratik, shoqëror dhe ekonomik të vendit. Bashkësia ndërkombëtare siguroi një mbështetje substanciale për rindërtimin e pasluftës dhe rivitalizimin e Kosovës. Dhe, si rezultat, edhe pse me një shkallë të ulët të zhvillimit, u zbatua me sukses programi i rikonstruimit gjatë fazës emergjente, ku edhe u shënua progres në zhvillimin ekonomik, posaçërisht gjatë periudhës 1999-2002. Që nga periudha e dytë e vitit 1999 e deri në vitin 2002, aktivitetet ekonomike posaçërisht në sektorin e shërbimeve, tregtisë dhe ndërtimtarisë u rivitalizuan shumë shpejt dhe ndihmuan në rritjen e BPV (10-15%). Mirëpo, që nga 2002 rritja ekonomike u ngadalësua shpejt, madje janë shfaqur edhe disa sinjale të përkeqësimit serioz të pozitës sociale të banorëve, që kryesisht po manifestohet me rritje të papunësisë. Reduktimi i donacioneve ndërkombëtare për 75% në krahasim me periudhën deri më 2002, politikat dekurajuese të cilat nuk promovojnë investimet, problemet me qeverisje dhe zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë, shkaktojnë ulje drastike të dinamikës së rritjes ekonomike.

2.4. Kushtet dhe faktorët që ndikojnë/përkrahin qëndrueshmërinë ekonomike

Më poshtë do të trajtojmë disa nga kushtet thelbësore në Kosovë për të gjeneruar rritje ekonomike. Kushtet e nevojshme për mbështetjen e qëndrueshmërisë ekonomike mund të vështrohen nga aspekte të ndryshme:

- Kapitali/burimet njerëzore
- Pasuritë natyrore
- Akumulimi i kapitalit dhe burimet e investimeve
- Kapacitetet institucionale
- Stabiliteti makroekonomik dhe politikat ekonomike në zbatim
- Cilësia e infrastrukturës publike

2.4.1. Kapitali njerëzor

Rezultatet nga anketat me familje japin disa indikacione lidhur me dinamikën dhe strukturën e popullsisë në Kosovë. Riinvesti ka realizuar dy anketa të gjera me familje gjatë periudhës së pasluftës (gusht 1999 dhe janar 2003). Të dy këto anketa sigurojnë një bazë të qëndrueshme për të vlerësuar se gjatë dhjetë viteve të fundit popullata është rritur për rreth 26%. Në skenarin ku kjo përqindje është aplikuar në të dhëna reale statistikore sipas të cilave vlerësohej se në vitin 1991 Kosova kishte 1.956.000 banorë, del se Kosova në vitin 2001 duhet të kishte 2.460.000 banorë. Ndërsa kalkulojmë edhe periudhën pas vitit 2001 (2002 - 2004), numri i banorëve duhet të sillet rreth 2.5 milionë, duke marrë parasysh edhe komponentin migrues. Bazuar në këto rezultate, çdo familje mesatarisht ka 1.1 persona në mërgim dhe, sipas një llogaritjeje të thjeshtë, del se rreth 350.000 kosovarë jetojnë jashtë shtetit. Nëse këtij numri i shtojmë edhe 100.000 kosovarë serbë dhe minoritete të tjera të zhvendosur pas luftës, del se jashtë vendit jetojnë rreth 450.000 shtetas kosovarë. Këto vlerësime na ndihmojnë që të konkludojmë se përafërsisht në Kosovë duhet të ketë 2-2.1 milionë banorë rezidentë.

Pritet që në vitin 2015 vendi ynë të ketë rreth 2.4 milionë rezidentë. Rritja mesatare e popullsisë vlerësohet të jetë ndërmjet 1.6 dhe 1.8 %. Një ulje më e madhe në rritjen e popullsisë nuk mund të pritet, sepse në Kosovë ende dominon një popullatë e re.

Tabela 3. Vlerësimet e banorëve për vitin 2015

Viti	2003	2015
Shkalla vjetore 1.6 %	2, 000, 000	2, 380, 000
Shkalla vjetore 1.7 %	2, 000, 000	2, 400, 000
Shkalla vjetore 1.8 %	2, 000, 000	2, 434, 000

Burimi: Riinvest, shtator 2004

Në anën tjetër, komponenti i emigrimit mund të shënojë rritje nëse vendi nuk do të mund të gjenerojë rritje ekonomike dhe punësim të qëndrueshëm. Pra, siç pamë edhe më lart, një rritje absolute e popullatës prej 400.000 banorë deri në vitin 2015 paraqet një sfidë

serioze dhe, në të njëjtën kohë, krijon edhe kërkesa të reja për arsim, punësim, banim dhe shërbime publike.

2.4.2. Niveli arsimor i popullsisë

Popullata në moshën mbi 18 vjeçare ka në mesatare prej 11 vjet shkollimi. Kjo është tipike për një vend me zhvillim mesatar në kuadër të vendeve në zhvillim. Bazuar në


të dhënat e anketës me familje dhe tregun e punës të Riinvestit (dhjetor 2002), vetëm 13% e popullsisë kosovare të grup-moshës 25-64 kanë kualifikim arsimor të lartë (18% e meshkujve dhe 8% e femrave), krahasuar me 23% të meshkujve dhe 20% të femrave në BE, 36% të meshkujve dhe 32% të femrave në Japoni dhe 37% të të gjithë popullsisë në SHBA. Kjo përqindje e ulët e njerëzve me arsim të lartë dhe kërkesat në rritje të tregut të punës për këtë lloj kualifikimi, do të ushtrojnë presion mbi sistemin arsimor në Kosovë për rritjen e kapaciteteve të tij.

Figura 1: Niveli i arsimit të popullsisë në Kosovë (grup-mosha 25-64)



Regjistrimi në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë më 2003 ishte rreth 10-12%, ndërsa në vendet postkomuniste, si në Poloni, ishte 30% (në SHBA 80% dhe në vendet e OECD 54%, shih pjesën a të figurës më poshtë). Mesatarisht në Kosovë ka rreth 1.000 studentë të përfshirë në arsimin e lartë për 10.000 banorë, krahasuar me 1.350 në Maqedoni dhe 4.243 në Slloveni. Të dyja këto vende kanë popullsi të ngjashme me Kosovën. Rritja e numrit të studentëve është edhe më e rëndësishme, duke pasur parasysh faktin se shumica e vendeve të reja të punës kërkojnë arsimim të lartë. Duke pasur parasysh ndikimin në rritjen e aftësisë konkurruese, rritjes së përfshirjes në arsimin e lartë duhet t'i jepet prioritet, me qëllim të rritjes së aftësisë konkurruese të ekonomisë kosovare.

Figura 2: Pjesëmarrja në arsimin e lartë (krahasime në nivel ndërkombëtar)



Burimi: CEPES/UNESCO, 2002 (mimeo)

2.4.3. Pasuritë natyrore

Kosova është e pasur me minerale (në veçanti me linjit, metale si plumb, zink, feronikel, magnezium, etj.).

Gjendja e tanishme teknologjike e këtyre xeheroreve, tani për tani, nuk lejon eksploatimin efektiv të xeheve, ndërsa kapacitetet e ndërtuara përpunuese, po ashtu, kanë një degjenerim teknologjik. Eksploatimi i këtyre xeheve varet nga interesi i investitorëve strategjikë.

Edhe pse ka sipërfaqe të vogël, Kosova dallohet me llojllojshmëri tokash, në formimin e të cilave ka ndikuar struktura relievore, baza gjeologjike, bota bimore, klima e hidro-

grafia dhe njeriu me mjetet dhe mënyrën e shfrytëzimit të tokave. Në bazë të vlerësimit të cilësisë së tokave, vlerësohet se në Kosovë janë 15% e sipërfaqeve me toka të mira,

Tabela 4. Rezervat e mineraleve në Kosovë (në milionë tonë) sipas vlerësimeve të bëra më 1985

Rezervat A + B + C		1985
I. Burimet energjetike minerare		
1.	Linjiti (miliardë tonë)	12.0
2.	Nafta (mil.tonë)	1.0
II Burimet minerare metalike		
1.	Xehja e boksitit	5.0
2.	Xehja e plumbit dhe zinkut	75.0
3.	Xehja e nikelit	40.0
4.	Xehja e kromit (1000 tonë)	0.6
5.	Xehja e hekurit	5.0
6.	Xehja e manganit	6.36
III Burimet minerare jometalike		
1.	Rërë kuarci dhe kuarc	30.0
2.	Magnezit	17.0
3.	Argjilë e padjegshme	8.0
4.	Xehe azbesti	20.0
5.	Bentonit	120.0
6.	Tuf	30.0
7.	Lapor çimentoje	175.0
8.	Gurë zbukurues	5.0

Burimi: Plani Strategjik i Zhvillimit të Kosovës 1985-2000 (Enti për Plan dhe Zhvillim i Kosovës)

29% toka të mesme dhe 56% me toka të dobëta. Tokat e cilësisë së mirë dhe mesatare, nën rreth 44% të fondit të tokës, përbëhen prej tokave humusore (11%), kryesisht në Rrafshin e Kosovës, tokave të murrme karbonate (8, 4%), aluviale (7, 8%), humuseve, rrënzinave dhe tokave të zeza në shkëmbinjtë serpentinerë. Pjesa më e madhe e sipërfaqeve me toka të dobëta ka shtrirje të gjerë në pjesët kodrinore e malore dhe përbëhet prej tokave të murrme të tharta, tokave diluviale, skeletore, moçalore dhe tokave të tjera jopjellore.

Kosova, në përgjithësi, ka 2812, 6 m³/106 ujë ose 89, 2 m³/sec., përkatësisht 8, 2 l/sec/km², me lartësinë e rrjedhjes 237 mm dhe koeficientin e rrjedhjes 38%⁵. Rrjedhja mesatare e ujërave nga rajoni perëndimor është 59,7 m³/sec, ndërsa nga rajoni lindor 29,5 m³/sec (raporti 2:1), që tregon për deficitin e ujërave në rajonin e Kosovës. Me qëllim të sigurimit të ujit të pijshëm, për industri dhe ujitje, në skajet e Fushës së Kosovës janë ngritur tri penda artificiale dhe janë formuar tri liqene: i Badovcit (mbi lumin Graçanka), i Batllavës (mbi lumin e Batllavës, degë e Llapit), i Gazivodës (mbi lumin Ibër). Përveç këtyre, në Kosovë janë ngritur edhe këto liqene artificiale: i Livoçit, i Përlepnicsës dhe ai i Radoniqit.

⁵ Ibid, fq.61

Për nga sasia e ujit të akumuluar, liqeni më i madh është ai i Gazivodës, me vëllim 390 mil.m3 ujë, i Radoniqit me 113 mil.m3 ujë, pastaj i Badovcit me 31 mil.m3 (kur ka qenë i plotë), i Batllavës 30 mil.m3, i Përlepnicsës 4,2 mil.m3, i Livoçit 1 mil.m3 dhe i Pridvoricës 0,49 mil.m3ujë.⁶




Figura 3. Harta e minierave dhe burimeve minerare

vitit 1995, situata e furnizimit me ujë të pijshëm për qytetin e Prishtinës dhe vendbanimet përreth është përmirësuar dukshëm.

Qytetet e Kosovës, në përgjithësi, kanë probleme të konsiderueshme të furnizimit me ujë të pijshëm. Për furnizim më të sigurt me ujë, nevojitet të ngrihen edhe disa liqene artificiale në pjesët periferike të fushave në viset kodrinore-malore e malore, mirëpo për ngritjen e tyre nevojiten sasi të mëdha të mjeteve materiale.

Si përfundim, mund të konstatohet se, sa i përket pasurive natyrore, Kosova mund të konsiderohet relativisht e pasur dhe ka përparësi në krahasim me vendet e rajonit. Burimet natyrore, si thëngjilli dhe disa minerale të tjera, mund të jenë faktorë kyç në krijimin e një qëndrueshmërie ekonomike dhe mund të sigurojnë një rritje ekonomike dhe joshje të IJD-ve dhe investitorëve strategjikë. Mirëpo, duhet të theksohet se këto pasuri, në veçanti minierat, mund të konsiderohen katalizatorë të zhvillimit vetëm nëse janë të shoqëruara me teknologji të avancuara dhe shërbime nga fusha e hulumtimeve zhvillimore (R&D), këshilla dhe shërbime financiare, pra nëse produkti në përmbajtjen etj., ndërthen njohuritë dhe teknologjitë e avancuara.

Liqeni i Badovcit dhe ai i Batllavës shërbejnë për furnizim me ujë të pijshëm të Prishtinës dhe vendbanimeve përreth, si dhe për furnizim me ujë teknik të objekteve industriale. Liqeni i Badovcit në vitet e fundit është zbratur dukshëm, ndërsa ai i Batllavës është në rrugë për t'u zbratur, pasi që shpenzimi i ujit nga liqenet është më i madh sesa prurja e lumenjve, të cilët i ushqejnë këto liqene.

Pas sjelljes së ujit nga kanali i Liqenit të Gazivodës në Liqenin e Badovcit, në fund të

6 Grup autorësh, pjesa e R.Pllanës, Gjeografia e Kosovës, Prishtinë 1995, fq.39-40

2.4.4. Investimet

Orientimi i kursimeve dhe depozitave në investimet dhe tërheqja e më shumë IJD-ve mbetet një çështje e madhe dhe shumë kritike. Niveli i tashëm i aktivitetit investues (23-25% e BPV-së) do të ishte më i përshtatshëm për një ekonomi në një stad të pjekur zhvillimi sesa për një ekonomi emergjente, e cila ka nevojë për rritje të madhe. Burimet private të aktivitetit investues dhe donacionet shënojnë një zvogëlim në pjesëmarrje në

Tabela 5. *Investimet në Kosovë (% e BPV)*

	2001	2002	2003	2004	2005
Investimet e përgjithshme	25.66	24.23	23.63	23.71	24.40
Private	16.19	16.19	13.05	12.53	15.28
Qeveria	0.86	1.71	3.96	5.98	6.03
Donatorët	8.61	6.49	3.76	2.95	3.09

Burimi: *Bazuar në vlerësimet e stafit të FMN, korrik 2005*

investimet e gjithëmbarshme pas viti 2002, përderisapjesëmarrja e qeverisë në investimet e përgjithshme ka shënuar rritje. Pjesa dërmuese e investimeve private ka qenë e orientuar në banim dhe më pak në aktivitete afariste, qeveria i ka orientuar investimet në shërbime publike, ndërsa donacionet kryesisht kanë shkuar në ndërtimin e kapaciteteve. Investimet direkte në aktivitete prodhuese pastaj për krijimin e të ardhurave dhe krijimi i vendeve të punës ende janë modeste. Madhësia, struktura dhe cilësia e aktiviteteve të tashme investuese nuk janë të përshtatshme për përkrahjen e rritjes ekonomike dhe për krijimin e vendeve të punës. Nëse merret parasysh raporti ekzistues ndërmjet tregut të punës dhe popullatës, është e nevojshme që të krijohen 25000-30000 vende për t'u ballafaquar me problemin e papunësisë. Kjo do të mundësohej vetëm në bazë të një rritjeje ekonomike dinamike, të përkrahur nga një ambient i favorshëm për investime. Mungesa e IJD-ve dhe e përkrahjes direkte të institucioneve financiare ndërkombëtare ndikon negativisht në vëllimin dhe në strukturën e investimeve të tashme.

2.4.5. Mjedisi institucional dhe politikat ekonomike

Pas suksesit të fazës emergjente të rindërtimit dhe rritjes ekonomike që rezultoi nga boom-i i rindërtimit, ambienti institucional dhe i politikave nuk ka qenë në gjendje të krijojë kushte për një rritje ekonomike të qëndrueshme dhe afatgjatë. Sa i përket anës institucionale, mund të thuhet se qeverisja/menaxhmenti i çështjeve lidhur me zhvillimin ekonomik ka qenë e vështirësuar për shkak të kualitetit dhe paqartësive lidhur me autorizimet, kompetencat dhe përgjegjësitë në relacionin UNMIK-IPVQ. Përkundër synimeve të proklamuar gjatë viteve 2003 dhe 2004 transferi i kompetencave tek IPVQ-të ishte shumë i ngadalshëm dhe i përcjellë me diskutime e konflikte ndërmjet Shtyllës IV dhe Qeverisë, sidomos lidhur me çështjet e privatizimit dhe disa aspekte të politikës buxhetore dhe të tatimeve. Kjo ka rezultuar në mungesën e sinergjisë dhe të qeverisjes efektive drejt rritjes ekonomike.

Deri tani janë krijuar kornizat bazë ligjore për bizneset dhe ligjet bazë komerciale. Ato kryesisht plotësojnë standardet e kërkuara për krijimin e një ekonomie moderne të hapur. Mekanizmat zbatues ende nuk veprojnë sa duhet dhe, për më tepër, nuk ekzistojnë analiza të mjaftueshme lidhur me progresin e implementimit të ligjeve dhe obligimeve kontraktuese. Po ashtu, në një pjesë të Kosovës (pjesa veriore dhe enklavat) nuk ekziston një veprim dhe pranimi i ligjeve të UNMIK-ut/ Kosovës dhe atyre të IPVQ-ve. Të gjitha këto kanë efekte çrregulluese në treg dhe ndikojnë negativisht në rrethinat afariste dhe ligjin në përgjithësi. Anketat me NVM-të gjatë gjashtë viteve të fundit tregojnë se pronarët dhe menaxherët e NVM-ve private perceptojnë se barrierat kryesore për biznesin e tyre (në mesin e gjithsej 14 barrierave të listuara) janë konkurrenca jolojale, legjislacioni, korrupsioni, tatimet dhe qasja në burimet e financimit (Raporti i NVM-ve, Riinvest 2000, 2001, 2002, 2003 dhe 2004). Kjo është tipike për rrethina turbulente afariste, gjë që rezulton nga mungesa e kapaciteteve, por edhe angazhimi që kërkohet për zbatimin e ligjeve. Rritja e kapaciteteve dhe përgjegjshmërisë për zbatimin e ligjit duket se paraqet një faktor kritik për përparimet e mëtutjeshme në ndërtimin e rrethinave afariste të favorshme për rritjen ekonomike.

Në përgjithësi, politikat dhe mjedisi institucional duket se janë të përshtatshme për eliminimin e deformimeve në treg dhe për përkrahjen e qëndrueshmërisë makroekonomike. Mirëpo, në të njëjtën kohë, është e nevojshme që të analizohet më thellë dhe më konkretisht se sa këto politika janë të përshtatshme edhe për një ekonomi në zhvillim e sipër, e në veçanti për aktivitetet e reja prodhuese dhe eksportuese, si dhe për krijimin e vendeve të punës nëpërmjet gjenerimit të rritjes ekonomike.

Ngarkesat tatimore, në përgjithësi, nuk janë më të larta se në vendet fqinje. Lidhur me këtë Kosova do të mund të rangohej diku në nivelin mesatar. TVSH-ja është më e ulëta, tatimi në korporata është më i ulët sesa në Shqipëri, por më i lartë krahasuar me vendet tjera, tatimi në pronë duket se është më i lartë, tarifat doganore për pajisje janë ende jo të favorshme për investime. Pengesa kryesore duket se është aplikimi i TVSH-së dhe procedurat për rimbursimin e saj. Ngarkesa e përgjithshme tatimore, 26%, për shumicën e të mirave kapitale-pajisjeve, që duhet të paguhet menjëherë në kufi, nuk është e favorshme për përkrahjen e investimeve. Po ashtu, duket se ende nuk ka hapësirë të mjaftueshme për të bërë përmirësime në politikën tatimore në drejtim të një politike tatimore më të favorshme për investitorët. Si një shembull i mirë shpesh merret Estonia (tatime fikse dhe të ulëta, zonë e lirë tatimore për investitorë dhe burokraci e ulët).

Financimi i bizneseve bazohet kryesisht në vetëfinancim dhe në tregun e kredive të ofruara nga një sistem i ri dhe i shëndetshëm bankar gjatë pesë viteve të fundit. Mirëpo, normat e interesit dhe afatet e kthimit të kredive mbesin të papërshtatshme për investime serioze. Duhet analizuar masat e nevojshme për rritjen e konkurrencës në tregun e kredive, bashkëpunimin me organizata financiare ndërkombëtare/banka për linja të posaçme të kreditimit me kushte më të mira për sektorët e prodhimit dhe eksportit. Po ashtu, duhet menduar seriozisht për krijimin e procedurave specifike të përshpejtuara prioritare në gjykatat gjegjëse për zbatimin e obligimeve kontraktuese afariste dhe të hipotekave.

Marrëdhëniet tregtare me vendet fqinje, bazuar në marrëveshjet për tregti të lirë,

duhet të kompletohen pas atyre me Maqedoninë dhe Shqipërinë. Kjo do të krijonte një bazë më të fortë për investime vendore dhe të jashtme. Raportet tregtare me Serbinë dhe Malin e Zi duhet të rregullohen gjatë procesit të negociatave sipas principit të reciprocitetit.

2.4.6. Stabiliteti makroekonomik

Transaksionet financiare në euro kanë përkrahur stabilitetin ekonomik. Inflacioni ka qenë i ulët dhe, duke filluar nga nëntori i vitit të kaluar, deflacioni ka shoqëruar normat negative të rritjes ekonomike. Stabiliteti makroekonomik, po ashtu, mbështetet nga shpenzimet e matura buxhetore (26% në anën e të hyrave dhe 28.5% e BPV në anën e shpenzimeve) dhe kreditë e matura (16 % e BPV-së).

Tabela 6: Treguesit kryesorë makroekonomikë (në miliona euro)

Treguesit makroekonomikë	2001	2002	2003	2004	2005
BPV	2, 439	2, 447	2, 420	2, 505	2, 453
Konsumi	2, 680	2, 623	2, 600	2, 711	2, 660
Investimet:	661	603	572	594	600
- Qeveritare	6	15	36	169	148
- Private	409	408	404	359	375
- Donacionet	245	180	132	66	76
Bilanci tregtar	- 956	-838	-812	- 848	- 854

Burimi: Vlerësime të stafit të FMN-së (korrik 2005)

- shpërpjesëtimi në tregun e punës
- madhësia e buxhetit dhe nevojat për investime kapitale

Sipas vlerësimeve të stafit të FMN-së, konsumi i përgjithshëm është rreth 8-9% më i lartë sesa BPV dhe kjo mbulohet nga remitancat e dërguara nga kosovarët që punojnë jashtë.

Deficiti i lartë tregtar, ku eksportet mbulojnë një pjesë shumë të vogël të importeve (gjatë 2000: 2.9 %, 2001: 1.2 %, 2002: 2.7 % dhe 2003: 3.7 %, 2004: 5%), paraqet një anë tjetër serioze të shpërpjesëtimeve. Tejkalimi i këtij deficiti tregtar kaq të lartë varet nga implementimi i suksesshëm i politikave të integruara që çojnë drejt zhvillimit të bizneseve prodhuese që janë të afta për të konkurruar në tregun vendor dhe zhvillimin e sektorëve eksportues përmes investimeve të jashtme dhe privatizimit të NSH-ve.

Rritja e tashme ekonomike dhe struktura e investimeve nuk janë në gjendje të krijojnë vende të reja pune për absorbimin e hyrjeve të reja në tregun e punës. Për shkak të rrethanave demografike pritet që do të ekzistojë një rritje vjetore në ofertën e fuqisë punëtore për rreth 25.000 punëkërkes të rinj (hyrjet neto) në tregun e punës. Momen-

Në anën tjetër, stabiliteti makroekonomik rrezikohet seriozisht nga shpërpjesëtimet në shumë fusha kritike, siç janë ato:

- midis të BPV-së dhe konsumit
- deficiti tregtar shumë i lartë

talisht ekzistojnë mundësi të kufizuara për t'u ballafaquar me situatën, për shkak të krijimit të një numri të vogël të mundësive të reja për punësim. Kjo rezulton në një problem afatgjatë (83.1 % e të papunësuarve kanë qenë të punësuar për më gjatë se një vit).

Shpërpjesëtimi midis Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe kërkesës në rritje për financimin e shpenzimeve operative, në njërën anë, dhe investimeve kapitale në anën tjetër, paraqet një problem tjetër makroekonomik. Buxheti i Konsoliduar i Kosovës në vlerë prej €14 milionë përbën rreth 28.5% të BPV-së. Në anën tjetër, ekziston një kërkesë e madhe për përmirësimin e transportit (transporti në zonat rurale), ndërtimin e infrastrukturës publike të nevojshme për të përkrahur zhvillimin ekonomik dhe punësimin, si dhe investimet për përmirësimin e cilësisë së arsimit. Të gjitha këto paraqesin një sfidë serioze. Përkundër progresit të arritur në ndërtimin e një buxheti të qëndrueshëm, të hyrat e pritura nuk mund të ballafaqohen me kërkesat për investime kapitale. Zgjidhja e këtij problemi mund të arrihet përmes rritjes së qëndrueshmërisë buxhetore dhe zhvillimit të kulturës fiskale, si dhe përmes bashkëpunimit me donatorët. Kosova ka një ekonomi emergjente, e cila në këtë situatë nuk mund të plotësojë kërkesat për investime kapitale. Një çështje tjetër kritike paraqet krijimi i një politike efektive të financimit dhe kreditimit ndërkombëtar për Kosovën brenda një periudhe afatshkurtër, pasi që vonesat do të kishin një ndikim negativ në proceset e zhvillimit ekonomik.

Nëse përcjellim situatën në Kosovë gjatë viteve të fundit, vërehet se ka ekzistuar një ngecje radikale në rritjen ekonomike, e cila ka pasur një ndikim negativ në situatën e përshkruar më lart. Arsyet kryesore mbesin menaxhmenti i pasuksesshëm gjatë tranzicionit prej fazës emergjente drejt fazës së zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm.

2.4.7. Infrastruktura dhe shërbimet publike

Niveli i tashëm i zhvillimit të infrastrukturës publike ofron kushte vetëm për nevojat elementare të popullsisë dhe të ekonomisë. Energjia, me nivelin ekzistues teknologjik të kapaciteteve të instaluar, nuk ofron furnizim të qëndrueshëm për të tejkaluar ndërprerjet dhe importin. Aktivizimi i disa industrive të minierave dhe zhvillimi i ri ekonomik do të kërkojnë investime për rivitalizimin e kapaciteteve ekzistuese të termocentraleve dhe për ndërtimin e termocentralit me rreth 1000 MW dhe aktivizimin e minierës së re të linjitet.

Telekomunikacioni, me monopolin ekzistues të ofruesit publik, po ashtu, nuk është në gjendje të ofrojë shërbime cilësore. Çmimet e shërbimeve të telekomunikacionit janë shumë të larta.

Infrastruktura rrugore ofron vetëm kushtet elementare. Për shkak të cilësisë së rrugëve magjistrale dhe vëllimit të trafikut, nevojitet të shpenzohet mesatarisht 50-70% më shumë sesa në rrethanat normale për të arritur nga qytetet tjera në Prishtinë. Momentalisht Kosova është lënë jashtë korridoreve panevropiane. Përmirësimi i kushteve të trafikut, posaçërisht përmes korridoreve moderne Durrës-Prishtina-Nish e po ashtu

Mitrovicë-Shkup, do të ishte i nevojshëm për parandalimin e izolimit në rajon dhe më gjerë. Kjo çështje është e rëndësishme, pasi që do të mund të krijonte disa faktorë komplementarë, siç janë pozita e mirë në rajon, popullata e re dhe MTL me vendet e rajonit. Kjo do të përforconte aftësinë konkurruese në tregun e IJD-ve.

Zhvillimi i transportit të lirë interurban dhe suburban është i nevojshëm për përkrahjen policentrike dhe komplekse të zhvillimit rural. Në një distancë prej 20 km nga 7 qytetet kryesore janë të vendosur më shumë se 85% e popullsisë. Transporti i mirë do të ndikojë në zvogëlimin e migrimit në qytete dhe në shfrytëzimin më të mirë të resurseve në zonat rurale.

3.SI TË KRIJOHET RITJA EKONOMIKE

3.1. Nevoja për përshpejtimin e rritjes ekonomike

Edhe pse Kosova ka arritur disa suksese gjatë periudhës së pasluftës, në ditët e sotme ajo ballafaqohet me një normë papunësie prej 40%, me bilanc negativ tregtar të përshkruar më lart (importet mbulohen nga eksportet me 4-5%). Duke marrë parasysh se rreth 63% e popullatës janë nën moshën 30 vjeçare dhe se kapaciteti absorbues i ekonomisë është shumë i ulët, çdo vit paraqiten 25.000-30.000 punëkërkues të rinj në tregun e punës. Kjo kërkon një rritje në punësim me një normë vjetore prej rreth 6-7%. Faktori tjetër kritik është rritja e eksporteve. Pjesëmarrja e bujqësisë në BPV është vlerësuar të jetë 25%, përderisa ajo e sektorit të shërbimeve është 60%. Pjesëmarrja e tashme e industrisë në BPV është 15%. Këto shpërpjesëtime strukturore me nivelin e tashëm të produktivitetit ndikojnë në nivelin e aftësisë konkurruese dhe në vëllimin e cilësinë e ofertës së eksportit.

3.2. Skenarët e mundshëm të rritjes ekonomike

Pyetja nuk qëndron në atë se a ka nevojë Kosova për normë dinamike të rritjes ekonomike, por më shumë për mënyrën e arritjes së saj. Si të aktivizohen burimet e rritjes ekonomike apo “si të ushqehen forcat motorike të rritjes”. Disa shtete të Evropës Qendrore, si dhe disa të Evropës Juglindore, kanë arritur norma të larta të rritjes ekonomike, të ngjashme me ato për të cilat ka nevojë Kosova gjatë periudhës së tranzicionit (shih tabelën nr. 2). Ato kanë bazuar suksesin e tyre kryesisht në imponimin e liberalizimit të proceseve, në rritjen e përparësive konkurruese, si dhe në krijimin e një ambienti të favorshëm afarist. Këto përvoja janë mjaft të dobishme kur diskutohen skenarët potencialë të rritjes ekonomike në Kosovë, si dhe gjatë marrjes parasysh të faktorëve që kanë ndikim në rritjen ekonomike të diskutuar më lart. Duke u nisur nga kushtet e tashme dhe disa nga faktorët kyç që do të mund të ndikojnë si në aktivitetet investuese ashtu edhe në rritjen e aftësisë konkurruese të ekonomisë, ne kemi hartuar tre skenarë: “çka nëse”. Secili prej këtyre skenarëve krijon kushte të caktuara për zhvillim dhe investime.

SKENARI (1)

Rrethina dhe faktorët me ndikim

- Stagnimi në implementimin e standardeve, ligjit;
- Korrupsioni rritës, qeverisja joefektive;
- Shtyrja e vendimit mbi statusin final;
- Vonesa në reformimin e shërbimeve publike dhe në përfundimin e procesit të privatizimit;
- Mungesa e bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare financiare;

**Rritja ekonomike lokale
BPV 1-3%.**

Efektet/pasojat

- Përkeqësimi i situatës ekonomike dhe sociale;
- Rritja e papunësisë dhe varfërisë;
- Probleme me deficitin buxhetor dhe stabilitetin social dhe politik;
- Emigrimi ilegal i popullsisë në vendet perëndimore;

SKENARI (2)

Rrethina dhe faktorët me ndikim

- Statusi politik është i adresuar, por disa nga paqartësitë mbesin;
- Asistencë ndërkombëtare ofrohet për disa çështje të sigurisë; mekanizmat përcjellës
- Pjesëmarrja në procesin me BE, në vend të marrëveshjes për asociim.
- Institucionet shënojnë progres në zbatimin e ligjeve ekzistuese;
- Bashkëpunim e jo anëtarësim në BB dhe FMN;
- Integrimi i Kosovës në marrëveshjet evropiane dhe qasja e Kosovës në korridoret e trafikut panevropian;
- Përfundimi i suksesshëm i procesit të privatizimit dhe ristrukturimi i ndërmarrjeve publike.

**Rritja mesatare ekonomike BPV:
4- 7%**

Efektet/pasojat

- Rritja e punësimit 3-5% (12000- 15.000 vende të reja pune çdo vit), numri i të papunëve rritet ose stagnon;
- Përmirësim i caktueshëm i cilësisë së jetës - zvogëlimi i varfërisë
- Zvogëlimi i debanceve makroekonomike

SKENARI (3)

Rrethina dhe faktorët me ndikim

- Efektivitet në implementimin e ligjit dhe politikave ekonomike, korrupsioni është zvogëluar në mënyrë efektive;
- Dykuptimësia në lidhje me statusin është eliminuar;
- Procesi i integritimit në BE ka përparuar dhe është realizuar pjesëmarrja në fondet strukture;
- Anëtarësimi i Kosovës në organizatat ndërkombëtare;
- Përmirësimi i cilësisë së arsimit - janë arritur standardet ndërkombëtare;
- Rrethinë e përshtatshme për investitorë të huaj dhe vendorë.

Rritja ekonomike dinamike, BPV: 8-10%

Efektet/pasojat

- Papunësia zvogëlohet për 6-8%; rreth 25000 vende të reja të punës krijohen brenda vitit;
- Varfëria zhduket (më së paku përgjysmohet);
- Stabilitet buxhetor;
- Emigrimi zvogëlohet;
- Stabilitet social dhe politik;
- Zvogëlohet hendeku i zhvillimit me vendet tjera të BE-së.

Tabela 7. Vlerësimet tentative të indikatorëve kryesorë makroekonomikë

	2004	2005	2009	2010	2015
BPV (2006-2008) 5 %	2, 505	2, 453			
Buxheti	767	746			
Investimet	538	713			
Punësimi '000	430	443			
Popullsia '000	2, 000	2, 034			
BPV (2009-2015) 9%			3, 095	3, 374	5, 191
Buxheti (32%)			991	1, 080	1, 661
Investimet			1, 038	1, 181	1, 817
Punësimi '000			513	544	728
Popullsia '000			2, 176	2, 213	2, 407

Burimi: Vlerësimet e Institutit Riinvest

Duke marrë parasysh kushtet aktuale dhe zhvillimet e pritura ekonomike, zhvillimi është ndarë në dy faza. Faza e parë, periudha 2004–2008, përfshin elemente të skenarit të parë dhe të dytë. Faza e dytë, që përfshin periudhën 2009–2015 dhe bazohet vetëm në skenarin e tretë. Gjatë fazës së parë (2004–2008), e cila bazohet në një nivel të ulët të

zhvillimit ekonomik, do të kishim një rritje ekonomike në mesatare prej 3- 5 %. Ky nivel i rritjes ekonomike do të kërkonte një normë të investimeve prej së paku 27 %, e cila do të rriste punësimin mesatarisht për 3 %.

Në anën tjetër, gjatë fazës së dytë do të kishim një rritje ekonomike prej 9 %. Për të arritur këtë nivel, investimet do të duhej të rriten nga 27% e BPV-së në 30-35% të BPV-së; si pasojë e kësaj do të kishim një rritje vjetore në punësim prej 6% pas vitit 2008. Rritja ekonomike do të influencohet nga efektet multiplikative të investimeve të vitit paraprak.

Ky skenar do të kërkonte rreth 14 miliardë euro investime deri në vitin 2015. Kjo imponon mjaft obligime për institucionet që duhet të punojnë për të krijuar një ambient të favorshëm për investitorë dhe për të rritur kapacitetin absorbues të qeverisjes dhe të menaxhimit ekonomik në nivelin mikro dhe makro.

3.3. Burimet potenciale të rritjes ekonomike

Nëse marrim parasysh sektorët që do të mund të krijojnë rritje ekonomike, është e qartë se përkrahja e një sektori apo një grupi të ngushtë sektorësh përmes politikave industriale nuk do të sjellë qëndrueshmëri afatgjatë të rritjes ekonomike. Më e preferuar është alternativa ku pranohen mundësi të ndryshme me një kombinim sektorial. Këtu do të prezantojmë vetëm disa mundësi.

(a) Sektori i NVM-ve momentalisht është sektori më vital. Do të mund të vazhdonte zhvillimi i NVM-ve, nëse rrethina afariste përmirësohet (skenarët II dhe III). Disa sektorë të industrisë së prodhimeve bujqësore (qumështi dhe lëngjet) tashmë kanë kontribuar përmes zëvendësimit të importit dhe kanë filluar eksportin në vendet fqinje. Përbrenda sektorëve tradicionalë, materialet ndërtimore dhe industria e ndërtimit, si dhe shërbimet lidhur me to, do të mund të zhvilloheshin. Në fazën e mëvonshme NVM-të në fushën e shërbimeve me vlerë të shtuar të lartë, të mbështetura me rezultate më të mira nga sistemi i edukimit, paraqesin një opsion tjetër.

(b) Sektori i energjisë, bazuar në rezervat e linjtit në Kosovë (vlerësohen të jenë 11-14 miliardë tonelata), konsiderohet se ka cilësi të mirë krahasuar me rajonet tjera. Kjo e bën këtë sektor që të ketë përparësi konkurruese në kuptimin e kostos së prodhimit. Ky fakt do të ndikonte në tërheqjen e investitorëve për plotësimin e kërkesës vendore dhe për të eksportuar, duke marrë parasysh kërkesën potenciale për energji elektrike në rajon. Kjo do të kontribuonte në krijimin e rritjes ekonomike bazuar në tërheqjen e IJD-ve.

(c) Rivitalizimi i eksportuesve të mëhershëm dhe sektorit të minierave

Privatizimi i ndërmarrjes “Ferronikeli” do të paraqesë një mundësi për eksport për sektorin e minierave dhe do të përkrahë rritjen ekonomike. Po ashtu, Kosova është mjaft e pasur edhe me plumb, zink, nikel dhe magnez. Prandaj, rivitalizimi i minierave

të Trepçës në Stantërg, Kishnicë, Artanë (ish-Novobërdë) dhe Hajvali do të mund të krijonte një bazë të mirë për rritje ekonomike. Mirëpo, rivitalizimi i sektorit të minierave kërkon investime të mëdha kapitale, të cilat duhet të bazohen plotësisht në investime të huaja direkte. Përveç këtyre mundësive kryesore të mëparshme të eksportimit, disa eksportues të tjerë të mëparshëm duhet të merren parasysh, mirëpo në një rrethinë më të mirë, sidomos me përfundimin e privatizimit dhe me politika të favorshme të pasprivatizimit. Kosova gjatë viteve të tetëdhjeta ka eksportuar edhe produkte të përpunuara nga metali (amortizatorë dhe pjesë të tjera të industrisë së automobilave, elektromotorë, radiatorë, fletë të galvanizuara të zinkut, cilindra/gypa etj.), pastaj bateri, plastikë - shirita transportues dhe shirita të tjerë, verë etj. Në këtë fushë ekzistojnë tre shembuj (fabrika e fletëve të galvanizuara të zinkut, Ferronikeli dhe Ballkani). Tregjet e mëparshme të eksportit janë humbur, por përmes bashkëpunimit me investitorët e huaj do të mund të rifitoheshin këto tregje.

(d) Sektori i bujqësisë, duke marrë parasysh ngastrat e vogla, nuk do të mund të konkurronte në prodhimin e drithërave, por duhet të përqendrohet në këta sektorë: pemëtari, blegtori dhe prodhim të mishit. Disa produkte me firmë do të mund të prodhoheshin edhe për eksport, sidomos nëse mund të realizohen programet për produkte të shëndetshme në kuptimin rrethanor/ekologjik.

(e) Shërbimet – shërbimet me vlerë të shtuar të lartë (servisimi i kompjuterëve, industria softuerike, shërbimet informatike, shërbimet financiare etj.) dhe turizmi, sidomos turizmi dimëror, duhet të merren parasysh dhe të analizohen për tërheqjen e investitorëve.

4. INVESTIMET E NEVOJSHME PËR RRITJEN EKONOMIKE DHE QËNDRUESHMËRI

4.1. Projektimet indikative të investimeve të nevojshme

Në rastin e Kosovës, vlerësimet e kapaciteteve investuese (sektorët&burimet) janë posaçërisht e rëndësishme duke marrë para sysh nevojën që ka Kosova për mobilizimin e të gjitha burimeve investuese. Kjo është posaçërisht e rëndësishme për vlerësimin e kapaciteteve investuese publike. Ky vlerësim është plotësisht indikativ dhe është i dedikuar për të treguar se çfarë përpjekjesh duhet bërë për të realizuar një rritje dinamike ekonomike.

Pasqyra 8. Burimet e indikative të investimeve (mil)

	Periudha 2005-2015	Pjesëmarrja
Investimet totale	13,894	100%
Privatë	8,237	59%
Qeveria	3,493	25%
Donatorët	2,164	16%

Burimi: Vlerësimet e Institutit Riinvest

Projektimetestruturës indikative investuese për periudhën 2005-2015 janë bazuar në këta faktorë:

- Trendët ekonomike të pas luftës në Kosovë;
- Planet aktuale të përpiluara nga institucionet e Kosovës dhe posaçërisht nga Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit,

Ministria e Energjetikës dhe Minierave, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (Arsimi i lartë) si dhe disa projekte Brenda AKM-së (Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit);

- Përvojat e vendeve të tjera, posaçërisht përvojat e shteteve fqinje dhe shteteve në tranzicion;
- Objektivat zhvillimore.

4.2. Struktura e burimeve potenciale

Investimet vendore të bizneseve private dhe ekonomive shtëpiake duke përfshirë edhe remitancat vlerësohen të arrijnë 49% (6.848 miliard), kurse IJD – Investimet e jashtme të drejtpërdrejta 10% (rreth 1.389 miliard). Investimet publike do të sillen rreth

Pasqyra 9. Burimet e pritura të investimeve

Private		Publike		Donatorët
59%		25%		16%
Biznesi	IJD	Buxheti	IFN	
49%	10%	17.3%	7.7%	16%
6,848	1,389	2,420	1,073	2,164

Burimi: Vlerësimet e Institutit Riinvest

17.3% (2.420 miliard). Burim kryesor i këtyre investimeve do të jetë buxheti, bonat e thesarit dhe kreditë ndërkombëtare prej IFN-ve. Pjesëmarrja e donatorëve në investime të përgjithshme parashihet të jetë rreth 16% (2.164 miliard).

Përfshirja e institucioneve financiare ndërkombëtare në investimet e përgjithshme pritet të jetë rreth 7.7% ose 1.073 miliardë .

4.3. Si të krijohet “ambienti i favorshëm për investime”

Duke analizuar skenarët e mësipërm, është e qartë se faktorët që ndikojnë në gjenerimin e rritjes ekonomike janë të lidhur, para së gjithash, me funksionimin efektiv të institucioneve demokratike, me zbatimin e ligjit dhe statusin e zgjedhur. Kjo do të përbënte bazën për të krijuar një ambient më të mirë të investimeve. Kësaj duhet t'i shtohet edhe qasja në kushte normale në IFN dhe mobilizimi i investimeve publike dhe private. Investimet e përshkruara më lart janë të domosdoshme, mirëpo vetëm ato nuk janë të mjaftueshme dhe vetvetiu nuk gjenerojnë zhvillim dhe rritje në shkallën e kërkuar. Duhet të krijohen dhe të funksionojnë edhe kushte të tjera ekonomike dhe institucionale, siç janë: ndryshimet e domosdoshme strukturale, kapacitetet institucionale, kompetencat menaxheriale, fuqia punëtore e kualifikuar dhe aftësia për hartimin dhe zbatimin e projekteve.

Duke pas parasysh që gjatë vitit 2006 statusi i Kosovës pritet të zgjidhet, gjithashtu pritet të vazhdojë edhe asistenca teknike dhe financiare e bashkësisë ndërkombëtare, dhe në këtë mënyrë dy kushtet e lartpërmendura do të realizohen. Rritja ekonomike për gjenerimin e investimeve varet nga kapacitetet e resurseve njerëzore dhe institucionale, si dhe nga kapacitetet absorbuese për transformimin e këtyre investimeve në projekte të arsyeshme dhe në një rritje të qëndrueshme ekonomike. Për të filluar adresimin e problemit të papunësisë në mënyrë serioze, Kosova duhet të krijojë 250.000-300.000 vende të reja të punës në dhjetë vitet e ardhshme (ose 25.000-30.000 vende të reja të punës brenda një viti), që do të thotë një rritje e punësimit prej 6-7%. Kjo nënkupton që në vitin 2015 ne do të kemi rreth 750.000 punëtorë të punësuar ose, me fjalë të tjera, çdo i katërti banor do të krijojë të ardhura (aktualisht çdo i pesti banor është duke krijuar të ardhura). Nga kjo mund të nxjerrim si përfundim se është e domosdoshme që Kosova të bëhet një vend atraktiv për investime vendore dhe të huaja. Autorët janë të vetëdijshëm sa i përket kushteve jo të favorshme që ofron gjendja aktuale ekonomike për realizimin

e skenarit të tretë, por gjithashtu besojnë se mund të krijohen kushte për zhvillim sipas këtij skenari, i cili i përgjigjet ndërtimit të një shoqërie të suksesshme. Skenari i tretë nënkupton ndryshime të rëndësishme drejt përmirësimit të qeverisjes së zhvillimit ekonomik, duke u bazuar në zbatimin e ligjit, ngritjen e kapaciteteve të resurseve njerëzore, përmes përmirësimit të sistemit të arsimit dhe infrastrukturës publike. Këto tri prioritetë duhet të formojnë fokusin e Planit Strategjik dhe Zhvillimor të Kosovës.

E tërë kjo do të bazohet në stabilitetin ekonomik dhe politik. Ndërtimi i një paqeje të qëndrueshme dhe ofrimi i mundësive për të gjithë kosovarët, duke përfshirë edhe plotësimin e standardeve lidhur me të drejtat e minoriteteve, ka rëndësi vitale. Kjo do të jetë baza themelore për krijimin e imazhit të ri të Kosovës si destinacion i IJD-ve, që ka nevojë për një promovim më agresiv. Sa u përket politikave, ne kemi adresuar disa prej dobësive të tyre në kuadër të pikës 2.3.1 të këtij raporti. Mjedisi institucional i bazuar në politikat aktuale (tatimi, financimi dhe fushat e tjera) teknikisht dhe teorikisht është korrekt, megjithatë duhet të testohet përballë efekteve të deritashme dhe atyre që mund të ketë në të ardhmen zhvillimi ekonomik në kushte konkrete të një ekonomie që ka nevojë të promovojë sektorët emergjentë të eksportit dhe të prodhimit. Disa koncepte teorike, përvoja dhe praktika të prezantuara këtu, si dhe përvoja të vendeve të tjera, duhet të kihen parasysh dhe të përdoren në mënyrën më të mirë për të promovuar një rritje të qëndrueshme ekonomike në Kosovë.

5. DREJT NJË BUXHETI TË QËNDRUESHËM

5.1. Progresi deri tash

Pas luftës Kosova ka ndërtuar një sistem të ri buxhetor, duke u bazuar në përvojat e avancuara perëndimore. Deri në vitin 2002 me buxhetin ka operuar Autoriteti Qendror Fiskal brenda UNMIK-u. Pas formimit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, ajo filloi të ushtrojë kompetenca gjithnjë e më të gjera nga fusha e financave. Vazhdimisht është zgjeruar baza tatimore dhe ajo tani përfshin pjesën më të madhe të tatimeve të drejtpërdrejta dhe indirekte, të cilat aplikohen në vendet e tjera në tranzicion e të cilat janë verifikuar si të pranueshme në ekonominë e tregut. Është ndërtuar një administratë e re tatimore, ndërsa mungesa e përvojës së saj është kompensuar me trajnime të vazhdueshme, si nga ana e Shtyllës IV të UNMIK-ut ashtu edhe nga USAID-i. Një rol të rëndësishëm në forcimin dhe në konsolidimin buxhetor, si dhe në mbarëvajtjen e punës së Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, e ka prezenca dhe asistenca e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore.

Në tre vitet e fundit, Buxheti i Konsoliduar i Kosovës krijohet vetëm nga të hyrat e brendshme. Me këtë është demonstruar kapacitet për të ndërtuar buxhet të qëndrueshëm, i cili paraqet një faktor të rëndësishëm për qëndrueshmërinë (viability) ekonomike. Megjithatë, në këtë periudhë tranzitore, për shkak të problemeve strukturale në ekonominë e Kosovës, qëndrueshmëria buxhetore ballafaqohet me disa probleme të cilat shkurtimisht do të prezantohen në vijim.

5.2. Problemet aktuale

Të hyrat që krijohen nga aplikimi i instrumenteve tatimore në kufi përbëjnë rreth 80% të të hyrave të përgjithshme tatimore, kurse ato të brendshme akoma janë mjaft modeste. Ndërrimi i raporteve të këtyre të hyrave përmes krijimit të një kapaciteti më të fuqishëm për arkëtimin më të madh të tatimeve brenda vendit kundrejt atyre në kufi do të ketë ndikim të fuqishëm në konsolidimin e buxhetit dhe në qëndrueshmërinë e tij afatgjatë. Pas një suficiti të shënuar deri në vitin 2003, nga viti 2004 buxheti i Kosovës kalon në një deficit i cili vazhdon të jetë prezent edhe tani. Deficiti buxhetor në vitin 2005 merr pjesë me 13% të konsumit buxhetor ose rreth 3.8% të GDP-së. Deficiti gjatë kësaj periudhe është mbuluar nga tepricat buxhetore të akumuluar deri në vitin 2003, përkatësisht nga suficiti në vitet paraprake. Mirëpo, me këto mjete nuk mund të lloga-

ritet mbulimi i deficitit për një periudhë të ardhshme afatmesme, përkatësisht pas vitit 2006. Mbulimi i konsumit më të lartë, i cili duhet të përballojë nevojat e rritura buxhetore nga të hyrat buxhetore, duhet të arrihet me rritjen e të hyrave buxhetore, duke krijuar kushte që pjesëmarrja e të ardhurave fiskale në GDP të sillet rreth 30%, kurse pjesëmarrja e konsumit buxhetor në GDP të mos kalojë mbi 32%. Nevojat për investime përtej këtij kufiri do të mbuloheshin përmes instrumenteve të borxhit dhe kthimit të huave nga ndërmarrjet publike.

Është e qartë se, për të përballuar nevojat e rritura, sidomos për investime, Kosova duhet të ketë një buxhet më të madh. Rritja e buxhetit në periudhën e ardhshme do të mbështetej në arkëtimin më efikas të tatimeve dhe në rritjen ekonomike. Mirëpo, projeksionet lidhur me normën e rritjes ekonomike për periudhën e ardhshme dallojnë. MEF (USAID) gjatë hartimit të buxhetit për vitin 2006 dhe projeksioneve për vitin 2007 bazohet në normën e rritjes ekonomike prej rreth 2%. Banka Botërore në projektimin e shpenzimeve afatmesme (2005-2010) niset ka dy skenarë makroekonomikë, të cilët nisen nga supozimet e ndryshme mbi shpejtësinë e programit të reformave ekonomike dhe stabiliteti politik dhe nga ndikimi pozitiv që ato mund të kenë në investimet e brendshme dhe në rritjen e eksportit. Supozohet se rritja reale e GDP-së për vitin 2005 do të jetë rreth 1% me rritje graduale deri në 3.5% në vitin 2010. Në skenarin e rritjes së lartë llogaritet që reformat e sektorit të energjisë të rezultojnë shpejt në investime të reja dhe në rritje më të lartë prej 3.7% në vitin 2007 deri në 5.2% në vitin 2010. Ndërkaq, llogaritet që inflacioni të jetë në nivel të mesatareve të UE, prej rreth 1.8% në vit. Sipas alternativës së rritjes më të shpejtë, të hyrat totale buxhetore në vitin 2010 llogariten të jenë rreth 877 milionë euro. Në anën tjetër, Instituti për Hulumtime Zhvillimore “Riinvest”, në hulumtimet e tij, ka ndërtuar tre skenarë të zhvillimit të mundshëm ekonomik për periudhën e ardhshme dhjetëvjeçare. Me një rritje mesatare ekonomike prej 4-7% deri në vitin 2008, dhe me një rritje të lartë prej 9% pas këtij viti, llogaritet që në vitin 2010 buxheti i Kosovës do të duhej të arrinte në rreth 1.080 milionë €. Kjo rritje do të realizohet në qoftë se zgjidhet statusi politik i Kosovës dhe vendi ynë merr përgjegjësitë e plota për zbatimin e ligjit, nëse bëhen përmirësime substanciale në qeverisje, nëse zhvillohen proceset për integrim në Bashkësinë Evropiane, nëse reduktohet korrupsioni dhe krijohet një mjedis miqësor për investime.

Të hyrat buxhetore të planifikuara për vitin 2005 (prej 629 milionë € marrin pjesë me 25.6% në GDP, kurse edhe në vitin 2006 (planifikohen rreth 656 milionë € do të kenë pjesëmarrje përafërsisht të njëjtë në GDP. Ndërkaq, pjesëmarrja e konsumit buxhetor në GDP në vitin 2006 planifikohet të bie në 28% nga 30% sa ishte paraparë për këtë vit. Mund të konsiderohet se një buxhet rreth 30-32% nuk do të ishte problematik për rritjen ekonomike në Kosovë. Ngarkesa përtej këtij niveli, sipas disa përvojave ndërkombëtare, mund të shprehet me efekte negative në rritjen ekonomike.

Problemi më evident i buxhetit është përballimi i nevojave për investime kapitale, qoftë për ndërtimin e objekteve të reja apo për mirëmbajtjen e tyre. Disa nga këto nevo-

ja janë përshkruar me lart. Projektionet e deritanishme të investimeve kapitale janë të shkëputura nga strategjia e zhvillimit ekonomik, për shkak të mungesës së kësaj strategjie. Prandaj, PIP i hartuar dhe i aprovuar në qeveri duhet të harmonizohet me planin nacional të zhvillimit afatmesëm dhe me synimet themelore të zhvillimit ekonomik. Sipas asaj që mund të shihet tani, është për t'u pritur se Kosova do të përballlet me vështirësi, së paku afatmesme, për të siguruar investimet kapitale publike për shkak të problemeve strukturale. Së këndejmi, në këtë segment do të nevojitet mbështetja e IFN-ve dhe e donatorëve.

Në periudhën që vjen buxheti do të ballafaqohet me një kosto evidente të transferimit të kompetencave nga UNMIK-u në IPVQ. Ajo lidhet me punësimin në ministritë e reja, hapësirat për zyrë dhe kostot tjera rrjedhëse. Shpenzime më të mëdha mund të priten për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe atë të Mbrojtjes. Në buxhetin e vitit 2006 janë përfshirë shpenzimet për Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe atë të Drejtësisë. Zvogëlimi i prezencës së policisë ndërkombëtare në Kosovë, po ashtu, do të kërkojë shpenzime shtesë për funksionet shtesë të stafit vendor, për pajisjet dhe shërbimet të cilat deri më tani i ka kryer policia ndërkombëtare. Tani për tani nuk është e njohur kostoja e saktë e funksioneve të reja, mirëpo është e qartë se transferi i vazhdueshëm i kompetencave do të përcillet me implikime fiskale sa u përket pagave dhe mëditjeve, si dhe shpenzimeve për mallra, shërbime dhe investime kapitale.

Kosovën gjatë kësaj periudhe e ka karakterizuar ngadalësia e madhe në ristrukturimin e ndërmarrjeve publike, siç janë KEK-u, PTK-ja, Aeroporti, Hekurudhat e UNMIK-ut, kompanitë regionale të ngrohjes, ato të ujit të pijes dhe të higjienës. Janë shpenzuar shumë mjete nga buxheti për nevojat e këtyre ndërmarrjeve dhe sidomos për KEK-un.. Nga ana tjetër, eficienca e këtyre ndërmarrjeve rezulton të jetë shumë e ulët. Është krijuar një varshmëri e paarsyeshme e funksionimit të shërbimeve publike nga burimet buxhetore të financimit, ndërsa shërbimet vazhdojnë të jenë të shtrenjta dhe jocilësore. Intervenimi me mjete buxhetore ka kompensuar menaxhmentin joefektiv dhe ka prolonguar procesin e ristrukturimit, korporatizimit dhe liberalizimit të këtij tregu. Një praktikë e tillë ka krijuar një gjendje paradoksale, në të cilën tatimpaguesi merr për barrë mungesat dhe lëshimet organizative dhe administrative të AKM-së dhe të KEK-ut. Në rastin e energjisë kjo është shprehur negativisht në grumbullimin e borxheve dhe në rregullsinë e pagesave nga konsumatorët. Zgjidhja duhet kërkuar në liberalizimin e tregut të shërbimeve publike, duke krijuar kushte për investime private dhe konkurrencë më të gjerë në treg. Kjo do ta lironte buxhetin nga këto obligime të paarsyeshme dhe do ta forconte përgjegjësinë e ndërmarrjeve publike.

Kosova duhet të llogarisë se pas zgjidhjes së statusit politik të saj do të marrë mbi vete pjesën e borxhit të jashtëm që asaj i takon, sikurse edhe të gjitha njësitë e federatës së dikurshme jugosllave, që tanimë janë pavarësuar. Mirëpo, institucionet financiare ndërkombëtare duhet ta kenë parasysh faktin se rritja e nivelit të borxhit të jashtëm të Kosovës pas vitit 1990 nuk ka ndodhur për shkak të hezitimit të Kosovës që atë ta

paguajë, por për shkak se këtë e pamundësoi okupimi i saj nga Serbia. Prandaj, çështja e servisimit të borxhit do të shqyrtohej sipas specifikave në tre periudha:

- a. borxhi i jashtëm deri në vitin 1990;
- b. borxhi i jashtëm nga vitit 1990 deri në qershor të vitit 1999 dhe
- c. vazhdimësia e borxhit të vitit 1990 pas qershorit të vitit 1999 dhe në vijim.

Institucionet kosovare do ta pranonin borxhin e jashtëm të Kosovës deri në vitin 1990, në pjesën që do të duhej të paguhej pas qershorit të vitit 1999, sipas planit të maturimit. Kontratat e këtij borxhi kanë qenë të ratifikuara nga federata jugosllave dhe Kuvendi i Kosovës. Me një marrëveshje me kreditorët e jashtëm, buxheti i Kosovës do të planifikonte kthimin e borxhit të jashtëm të periudhës para vitit 1990 dhe obligimet mbi këtë borxh nga muaji qershor i vitit 1999. Pjesa e borxhit që sipas planit të maturimit bie në periudhën korrik të vitit 1990 deri në qershor të vitit 1999 duhet të bie mbi Serbinë, pasi që ajo ka menaxhuar me ndërmarrjet publike dhe shoqërore, të cilat duhej të kthenin borxhin. Qeveria serbe do të ngarkohej me të gjitha kamatat për borxhin e pakthyer për këtë periudhë, si dhe do të merrte mbi vete çdo borxh eventual të cilin e ka krijuar gjatë periudhës së okupimit të Kosovës.

Numri i madh i të punësuarve tanimë në administratën/shërbimin publik ka ndikuar që pjesëmarrja e pagave në konsumin buxhetor të jetë shumë e lartë. Kjo ka filluar ta kërcënojë qëndrueshmërinë buxhetore dhe, sipas vlerësimeve të FMN-së, paraqet faktor potencial të destabilizimit të buxhetit. Situata e rëndë ekonomike kufizon mundësinë që zgjidhja e këtij problem të bëhet përmes zvogëlimit të numrit të të punësuarve në shërbimin civil, sepse kjo do të nënkuptonte shtimin e nivelit të papunësisë. Në anën tjetër, zvogëlimi i nivelit të pagave do të krijonte efekte negative në varfërinë edhe ashtu të lartë. Në afat të gjatë, ky problem do të neutralizohej përmes rritjes së vazhdueshme të të hyrave buxhetore dhe përmes ndërprerjes së shtimit të numrit të të punësuarve në këto shërbime, me kusht që punësimi për ministri dhe shërbime të reja të bëhet përmes rishpërndarjes së numrit të tanishëm të të punësuarve. Kjo do të krijonte kushte për një efikasitet më të lartë të shërbyesve civilë, pjesëmarrje relative më të vogël të pagave dhe mëditjeve në totalin e konsumit buxhetor dhe hapësirë për përmirësimin e nivelit të pagave të shërbyesve civilë në të ardhmen karshi efikasitetit të shërbimeve që ua ofrojnë qytetarëve në fusha të ndryshme. Kujdes të njëjtë meriton t'i kushtohet edhe racionalizimi i shpenzimeve për mallra dhe shërbime, sepse kjo fushë është lënë anash gjatë kësaj periudhe. Një qasje më racionale në këto dy fusha do të krijonte kushte që të bëhet më shumë në investimet kapitale në infrastrukturë, arsim, shkencë, shëndetësi etj., efektet e të cilave do të gjeneronin një zhvillim më propulziv ekonomik dhe një rritje të kërkesës afatgjate në treg.

Decentralizimi fiskal, i cili ishte i orientuar në fuqizimin e rolit të komunave në mbledhjen e të hyrave vetjake, nuk po i jep rezultatet e pritura. Diferencat e mëdha në normat e tatimit në pronë, si dhe transparenca e pamjaftueshme ndaj taksapaguesve në disa mjedise, ka ndikuar të ketë dallime të mëdha ndërmjet komunave sa i përket grumbullimit të tatimit në pronë dhe të hyrave vetjake në tërësi.

Rëndësi të madhe në qëndrueshmërinë buxhetore ka ngritja e kulturës fiskale, si te popullata ashtu edhe te institucionet shtetërore. Krijimi i një ndërlidhjeje dhe komunikimi ndërmjet tatimpaguesve dhe qeverisë, si dhe reflektimi i efekteve të buxhetit në shërbimet publike që u ofrohen popullsisë, do të jetë një faktor i rëndësishëm për rritjen e të hyrave buxhetore dhe për stabilitetin e tyre. Me rëndësi të madhe është të krijohet një transparencë dhe përgjegjësi buxhetore, e cila do të jetë në funksion të efijencës së konsumit buxhetor dhe zgjerimit të bazës fiskale. Përkundër rëndësisë së madhe që ka edukimi fiskal, ai megjithatë nuk mund ta kompensojë as ta zëvendësojë krijimin e mekanizmave detyrues dhe zbatimin e tyre efikas tek pagesa e tatimeve dhe faturave për shërbime publike. Tani këta mekanizma veprojnë fare pak dhe nuk ka arsye që kështu të vazhdojë më tutje.

6. PROBLEMET STRUKTURALE DHE NEVOJA PËR BASHKËPUNIM DHE ASISTENCË TEKNIKE NDËRKOMBËTARE

Kosova si një vend me ekonomi emergjente, pavarësisht nga fakti që është relativisht një vend i pasur me resurse të ndryshme, ballafaqohet me shumë sfida për të arritur një dinamikë të nevojshme në zhvillimin ekonomik. Tejkalimi i problemeve strukturale të pranishme, siç janë mungesa e infrastrukturës së duhur publike, papunësia, deindustrializimi dhe deficit i tregtar që kanë një origjinë nga një trashëgimi e gjatë e sidomos nga vitet e 90-ta, kërkon një përkrahje të mëtutjeshme të bashkësisë ndërkombëtare përmes asistencës efektive teknike dhe financiare.

Destinimet kryesore të një përkrahjeje të mëtutjeshme do të ishin:

- Përkrahja në ndërtimin e mëtutjeshëm të kapaciteteve në fushën e menaxhimit zhvillimor dhe në fushën e qeverisjes
- Ofrimi i asistencës financiare në përballimin e vështirësive aktuale buxhetore për investimet publike, posaçërisht në një periudhë afatmesme
- Krijimi i marrëdhënieve të duhura me kapacitete të plota me institucionet financiare ndërkombëtare

Bashkësia ndërkombëtare, përmes administratës së UNMIK-ut dhe Agjencioneve të Kombeve të Bashkuara, organizatave të agjencioneve të tjera (siç janë; AER, USAID, DFID, GTZ, SDC, SIDA dhe shumë të tjera) ka kontribuar në tejkalimin e pasojave të tmerrshme të luftës dhe në rindërtimin e shoqërisë kosovare, duke përfshirë themelimin e infrastrukturës institucionale, duke u bazuar në zgjedhje dhe votime të lira. Megjithatë, këto institucione kanë nevojë për një mbështetje edhe më efektive për ngritjen e kapaciteteve për zbatimin e ligjit, menaxhimin zhvillimor dhe qeverisës. Gjithashtu, përkrahja e mëtutjeshme në përmirësimin e kualitetit të edukimit do të ndikojë në ngritjen e kapaciteteve absorbuese për investime dhe zhvillim. Faza e ardhshme e kësaj asistence duhet të jetë plotësisht e drejtuar në rritjen e kapaciteteve e jo në “kryerjen e punëve”, punë të cilat kosovarët duhet të jenë në gjendje t’i kryejnë vetë.

Ndërprerja e zhvillimit dhe investimeve në infrastrukturë publike dhe në shërbime komunale gjatë viteve të 90-ta ka pasur pasoja shumë negative në kushtet për zhvillim. Buxheti i Konsoliduar i Kosovës do të ketë vështirësi, së paku në një periudhë mesatare, për të dhënë investime të domosdoshme derisa rritjet ekonomike janë pozitive dhe administrimi i tatimeve përmirëson edhe më tutje mbledhjen e tatimeve. Ky fakt do të ketë kërkesa dhe nevojë për asistencë direkte ndërkombëtare financiare në këtë fushë.

Bashkëpunimi me FMN dhe BB, të cilat kanë qenë prezente gjatë tërë periudhës së pasluftës, ka kontribuar në mënyrë të rëndësishme me asistencë teknike dhe buxhete

direkte falas gjatë viteve të para. Me përparimet në bisedimet për statusin final dhe finalizimin e tyre, pritët të themelohet krijimi i kapaciteteve të reja në këtë bashkëpunim. Tash, të dyja palët duhet të punojnë, e sidomos institucionet kosovare, për përgatitjen e projekteve të arsyeshme bankare dhe në menaxhimin e duhur të tyre në fazën implementuese.

Në këtë drejtim, disa iniciativa tashmë të diskutuara për bashkëpunim me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Bankën Evropiane për Investim (BEI) duhet të përforcohen. Bashkëpunimi me IFN-të duhet të themelohet dhe të organizohet brenda MEF-it dhe Qeverisë, për shkak të rëndësisë së madhe për krijimin e kushteve për zhvillim të qëndrueshëm drejt një rritjeje ekonomike të qëndrueshme.

ANEKSI 1.

PËRMBLEDHJE E PROFILIT EKONOMIK TË KOSOVËS

Kosova është e pozicionuar në qendër të Ballkanit Perëndimor, në një territor kompakt me një formë gati të rrumbullakët. Duke iu falënderuar këtij planifikimi urbanistik, kryeqyteti i Kosovës, Prishtina, është pothuajse në një distancë të barabartë prej Selanikut, Sofjes, Tiranës, Beogradit dhe Podgoricës, si dhe prej Budapestit, Bukureshtit dhe Zagrebit.

Në një sipërfaqe prej rreth 10.908 km², momentalisht jetojnë rreth 2 milionë banorë kosovarë (rreth 183 banorë për 1 km²). Rreth 90% të popullatës janë shqiptarë, përderisa gjysma e 10% të minoriteteve janë serbë. Densiteti i popullatës dhe rritja natyrale janë më të lartat në Evropë. Popullata është e re dhe energjike: 63% janë të moshës nën 30 vjeç, përderisa vetëm 5% janë të moshës më të vjetër se 65 vjeç. Përafërsisht 80% të popullatës janë të vendosur në distanca më pak se 20 km nga shtatë qendrat regjionale, të cilat çdonjëra prej tyre kanë mbi 100.000 banorë. Në dekadën e ardhshme, popullata e Kosovës pritet të rritet sipas mesatares vjetore që është 1.6-1.8%, kështu që deri më 2015 pritet të arrijë deri në 2.4 milionë banorë. Jo banuesit kosovarë e përbëjnë ¼ e popullatës, të cilët kryesisht kanë emigruar në Evropën Perëndimore. Ata janë të lidhur shumë me vendlindjen e tyre, duke dhënë kontribute dhe remitanca që deri më tash vlerësohen të jenë rreth 300 milionë euro.

Me një GDP(BPV) rreth 1200 euro për kokë banori (përafërsisht 1.500 \$ sipas normës aktuale) dhe indeks zhvillimor human prej 0.735 (Norvegjia 0.944, Maqedonia 0.784), Kosova është një vend në zhvillim, e renditur mbi mesin e listës së vendeve në zhvillim. Si një vend i pasluftës, me një trashëgimi të një historie të paleverdishme në fushën e zhvillimit, Kosova karakterizohet me mosbalancime të ndjeshme në konfigurimin e vet makroekonomik. Konsumi total e tejkalon GDP(BPV), eksporti mbulon importin me vetëm 4-5 %, norma e papunësisë është ndërmjet 40-45%, përderisa buxheti aktual i konsoliduar i Kosovës (rreth 28% i GDP/BPV) është i financuar krejtësisht nga tatimpaguesit kosovarë. Në këtë situatë, kjo mund të mbulojë vetëm 20 % të nevojës për investim publik.

Profili i strukturës ekonomike karakterizohet me pjesëmarrjen e madhe të sektorit të shërbimeve (me 60 %) dhe bujqësisë (me 25 %) në GDP/BPV, si pasojë e procesit të deindustrializimit gjatë viteve të 90-ta. Aktualisht pjesëmarrja e industrisë në GDP/BPV është vetëm 15%. Struktura industriale, shumica e së cilës është themeluar gjatë viteve të 70-ta dhe 80-ta, ka nevojë për renovim dhe rigjenerim teknologjik, përmes procesit të privatizimit që ka filluar. Bujqësia absorbon rreth 22% të klasës punëtore të Kosovës, me kufizime për familjet si pasojë e pronave shumë të vogla tokësore: struktura e prodhimit jokonkurrense nuk siguron kualitetin e konsumit as për familjet rurale. Bujqësia kontribuon me rreth 9% të të hyrave (para) në familjet rurale, përderisa konsumin e

mbulojnë me produkte të vetë prodhuara, që ndryshon prej 12% (vezë) e deri në 51% (drithëra). Shërbimet kryesisht janë të lidhura me biznese, hoteleri dhe aktivitete të inxhinierisë civile.

Sektori privat (duke përfshirë edhe fermerët/bujqit) kontribuon së paku me 60% të GDP/BPV, me dominimin e sektorit vital të NVM-ve. Ky sektor dominohet nga ndërmarrjet tregtare dhe komerciale (52%). Ekziston një tendencë e vogël për një rritje në bizneset prodhuese, kryesisht në fushën e ndërtimtarisë, përpunimit të ushqimit, industrisë së drurit & letrës dhe shërbimeve të disenjtit. Shumica e bizneseve private (mbi 97%) kanë të punësuar deri në pesë persona. Trendi për investime dhe ndërmarrësi është i konfrontuar me infrastrukturë publike joadekuate dhe barriera institucionale: konkurrencë të padrejtë, tatime joadekuate, vështirësi të qasjeve në financa dhe probleme në marrëdhëniet komerciale me vendet fqinje.

ANEKSI 2

BILANCI I TREGUT TË PUNËS SË KOSOVËS, 2002

Tabela 10. Bilanci i tregut të punës së Kosovës, 2002

Përshkrimi	Numri	Përqindja
Popullata	2, 050, 000	100.0%
Prej 0-15 vjeç	662, 150	32.3%
Prej 16-64 vjeç	1, 291, 500	63.0%
Mbi 65 vjeç	96, 370	4.7%
Popullata e moshës së punësimit	1, 210, 000	59.0%
Popullata aktive	702, 000	34.2%
Popullata joaktive (jashtë fuqisë punëtore)	508, 000	24.8%

Burimi: Riinvest (2002): Anketimi i familjeve dhe tregut të punës në Kosovë

Bibliografia

Vlerësimi i varfërisë në Kosovë: Promovimi i mundësisë, sigurisë dhe pjesëmarrja për të gjithë, Raport i Bankës Botërore 2005.

Memorandumi Ekonomik për Kosovën, Raport i Bankës Botërore 2004.

Poverty Reduction and Economic Management Unit Europe and Central Asia Region.

Kosovo Poverty Assessment - Volume I & II, December 20, 2001 WB.

Kosovo: Budget 2002 February 12, 2001 IMF.

Kosovo - Macroeconomic Issues and Fiscal Sustainability, February 1, 2001.

Kosovo 2001-2003 from Reconstruction to Growth, December 15, 2000 UNMIK

Kosovo: Budget 2001 November 17, 2000 WB

The World Bank Program in Support of Kosovo 2000-2001, July 25, 2000 WB

World Bank Group Transitional Support Strategy for Kosovo Progress Report April 2000

The Economic Consequences of the Kosovo Crisis: An Updated Assessment April 16, 1999 IMF/WB

The Economic Consequences of the Kosovo Crisis: A Preliminary Assessment of External Financing Needs and the Role of the Fund and the World Bank in the International Response

João Mariano Saldanha and Helder da Costa (1999), Economic viability of east Timor revisited: Outlook for the 21st Century. East Timor Study Group (ETSG), Working Paper: 01.

Leila Farsakh, Economic Viability of a Palestinian State in the West Bank and Gaza Strip: Is it Possible without Territorial Integrity and Sovereignty?(2001), The MIT Electronic Journal of Middle East Studies Crossing Boundaries: New Perspectives on the Middle East, Vol. 1, May 2001.

Fuelling Kosovo's Growth Engines: A Strategic Vision and Policy Priorities (2005), EU UNMIK Pillar, Economy Policy Office.

Xavier Sala-i-Martin, The independence of Catalonia: the economic viability. Colum-

bia University and UPF.

Justin Yifu Lin (Peking University and Hong Kong University of Science & Technology) Development Strategy, Viability, and Economic Convergence.

Profili socio-ekonomik i Kosovës dhe sfidat e zhvillimit, Riinvest 2005.

Zhvillimi ekonomi lokal dhe investimet e jashtme direkte, Riinvest 2004.

Sistemi i arsimit dhe zhvillimi ekonomik i Kosovës, Riinvest 2004.


Politikat tregtare dhe promovimi i eksportit në Kosovë, Riinvest 2003

Sistemi buxhetor i Kosovës - politikat dhe qëndrueshmëria, Riinvest 2003



Tregu i punës dhe papunësia në Kosovë, Riinvest 2002

Rindërtimi i Kosovës pas luftës - strategjia dhe politikat, Riinvest 2001

Ripërtëritja dhe rindërtimi i Kosovës pas luftës, Riinvest 1999.



50





EUROPEAN UNION

UNMIK



ECONOMIC POLICY OFFICE

Nxitja e rritjes ekonomike të Kosovës

- Një vizion strategjik dhe prioritetet e
politikave ekonomike -

Kontribut i Shtyllës së BE-së të UNMIK-ut për Planin e Zhvillimit të Kosovës

Shtylla e BE-së në UNMIK
Zyra e Politikave Ekonomike
Korrik 2005

Autorët: Andreas Wittkowsky
Elinor Bajraktari
Orhan Nikšić

Përmbajtja

1.	Qasja strategjike ndaj zhvillimit të Kosovës	55
1.1.	Një vizion për Kosovën	55
1.2.	Parimet kyç për një strategji të zhvillimit ekonomik	56
2.	Potencialet e rritjes	59
3.	Kufizimet e rritjes	60
3.1.	Kursimet	63
3.2.	Arsimi	67
3.3.	Infrastruktura	70
3.4.	Mjedisi institucional	71
3.5.	Promovimi i investimeve	73
4.	Konkluzioni: Qëllimet dhe prioritetet e politikës	75
	A - PËRMIRËSIMI I MJEDISIT	76
	B - SEKTORI PRIVAT DHE PROMOVIMI I INVESTIMEVE	77
	C - ZHVILLIMI I BURIMEVE NJERËZORE	78
	D - ZHVILLIMI I INFRASTRUKTURËS	78

1. Qasja strategjike ndaj zhvillimit të Kosovës

Një vizion i fortë ekonomik do t'u dhurojë kosovarëve siguri dhe shpresë, investitorëve potencialë do t'u japë ide se ku duhet të investohet, ndërsa qeverisë dhe politikanëve do t'u japë një udhërrëfyes se në ç'drejtim duhet të shkojë Kosova.

Integrimi në BE u ofron kosovarëve një zgjedhje për të lidhur vizionin e tyre me një të ardhme të përbashkët evropiane. Sidoqoftë, bashkërenditja me BE-në kërkon një transformim strukturor të ekonomisë së Kosovës nga aktivitetet e prodhimit të ulët në aktivitetet e prodhimit të lartë.

Politikat që kanë lidhje me reformat e nevojshme strukturore duhet të jenë rezultat i një kornize të gjithmbarshme dhe, në bazë të një strategjie të zhvillimit ekonomik, duhet të caktohen prioritetet.

1.1 Një vizion për Kosovën

Gjashtë vjet pas konfliktit, me një periudhë të ngjeshur të problemeve të rindërtimit, Kosovës i duhet një vizion i saj ekonomik. Vizioni do të avancojë qartësinë, unitetin dhe vazhdimësinë dhe do të ofrojë një ndjenjë të qartë të drejtimit dhe qëllimit. Ky vizion do të ndihmojë të bashkërendojë nxitësit dhe reagimet e njerëzve ndaj atyre nxitësve, si dhe do të inkurajojë mobilizimin e resurseve dhe alokimin efikas të tyre. Një vizion solid ekonomik do t'i japë Kosovës dhe popullit të saj një ndjenjë të orientimit strategjik dhe do t'u japë investitorëve potencialë një sinjal të qartë në lidhje me atë se nga po shkon ekonomia dhe cilat janë qëllimet e qeverisë.

Në kombinim me veprimet e besueshme të qeverisë, vizioni do të kontribuojë në tejkalimin e pasigurive të raportuara në lidhje me politikën ekonomike.¹ Në të vërtetë, që nga viti 1999, politikat ekonomike të Kosovës kanë qenë në përgjithësi të një standardi të lartë. Pasiguria rrjedh nga mungesa e komunikimit të vizionit dhe arsytimit të këtij vizioni para popullatës dhe komunitetit të biznesit, si edhe nga periudha e shkurtër kohore e operimit të politikave ekonomike. Prandaj, qeveria dhe akterët ekonomikë janë të detyruar të nxjerrin një vizion ekonomik, sa më parë që është e mundur

¹ Si për shembull, ato që janë raportuar nga Banka Botërore në "Vlerësimin e klimës investuese", përgatitur për "Memorandumin Ekonomik të Kosovës", 2004.

dhe sa më gjithëpërfshirës që është e mundur.

Kosova e ka mundësinë dhe zgjedhjen për ta drejtuar këtë vizion në një të ardhme të përbashkët evropiane. Agjenda e Selanikut e Bashkimit Evropian dhe e Procesit të Stabilizim Asociimit do të mundësojë një integrim gradual të Kosovës në familjen evropiane. Shpejtësia e këtij procesi do të varet në masë të madhe nga veprimet dhe zotimet e politikanëve dhe politikëbërësve të Kosovës. Orientimi i standardeve të jetesës drejt nivelit evropian është një objektiv i fortë i të gjithë kosovarëve. Sidoqoftë, integrimi në institucionet evropiane dhe bashkërenditja e standardeve të jetesës kërkojnë një ekonomi dinamike në Kosovë, që është konkurruese në rajon dhe në tregun më të gjerë evropian.

Në këtë kontekst, baza e vizionit të Kosovës duhet të jetë arritja e shkallës së një ngritjeje ambicioze dhe të qëndrueshme, duke identifikuar pengesat kryesore të ngritjes dhe duke gjetur mënyra për t'i hequr ato. Qindra barrierat qëndrojnë si pengesa në rrugën e zhvillimit (ngritjes) dhe largimi i të gjitha atyre nuk është një rrugëzgjdhje. Politikëbërësit duhet të koncentrohen në resurset për eliminimin e pengesave më ngatërruese në vend, që të synojnë pengesat më të lehta.

Në kohën e tashme, ekonomia e Kosovës mbështetet në disa aktivitete të prodhimit të ulët, që nuk mund ta mbajë në shkallë të qëndrueshme një aktivitet të lartë në një afat të gjatë. Aktivitetet ekonomike janë mbajtur (mbuluar) nga shërbimet e bëra nga prezenca e madhe ndërkombëtare dhe nga fluksi i parave të dërguara pas përfundimit të konfliktit. Gradualisht, kjo po zvogëlohet dhe ekonomia e Kosovës është duke zbuluar dobësitë e veta strukturore.

Për t'iu shmangur rënies së madhe të standardit jetësor, Kosovës i duhet një transformim ekonomik nga aktivitetet e prodhimit të ulët në aktivitete të prodhimit të lartë. Ky transformim mund të arrihet përmes promovimit të investimeve, zhvillimit të sektorit privat, arsimimit të përmirësuar dhe institucioneve të përforcuara. Qeveria duhet të luajë një rol kyç, duke siguruar që zhvillimi i sektorit privat dhe investimet, jo vetëm të mbeten në agjendën e vet, por edhe të bëhen pjesë kyç e programit të vet. Qeveria duhet të bëhet dhe të paraqitet si partner i besueshëm në sektorin privat, duke bashkëpunuar ngushtë me të.

1.2 Parimet kyç për një strategji të zhvillimit ekonomik

Politikat në lidhje me reformat e nevojshme strukturore duhet të jenë rezultat i një kornize të gjithmbarshme analitike dhe në bazë të një strategjie zhvillimore të caktohen prioritetet. Kjo nuk është një detyrë e lehtë, duke pasur parasysh gamën e variablave që ndikojnë në standardin jetësor dhe rrjetin kompleks të ndërlidhjeve përmes së cilave këto variabla e mbajnë njëra-tjetrën. Disenjimi i një strategjie të zhvillimit ekonomik për Kosovën është edhe më sfiduese, për shkak të mungesës së statistikave dhe periudhës së shkurtër kohore gjatë së cilës Kosova ka qëndruar si njësi e pavarur ekonomike me

një organizim të ndarë institucional dhe me politikat e duhura. Çështjet e caktuara janë gjurmuar deri në një masë të madhe në shumicën e rasteve nga këshilltarë të huaj, të cilët kanë një prezencë të madhe në Kosovë. Megjithatë, ato duhet të bashkohen në një kornizë që identifikon fushat e prioriteteve që mund të qasen në mënyrë aktive. Është me rëndësi që çështjet e politikave të mos analizohen të izoluara, siç ndodh shpesh, por kjo duhet të bëhet në ndërlidhje me njëra-tjetrën dhe në mënyrë sistematike.

Pas zgjedhjeve të vitit 2004, qeveria mori vendimin që të nisë një Plan të Zhvillimit të Kosovës (PZHK) dhe tani është duke e krijuar arkitekturën institucionale për ta bërë atë. Ky është një rezultat inkurajues i punës së Grupit të Strategjisë Ekonomike dhe Identifikimit të Projektit. I krijuar në mars të vitit 2003, dhe i përbërë nga përfaqësuesit e qeverisë, përfaqësuesit e administratës së UNMIK-ut dhe të donatorëve, grupi ka promovuar në mënyrë aktive rëndësinë, urgjencën dhe nevojën për Planin e Zhvillimit të Kosovës.² Tani qeveria ka marrë pozitën e drejtuesit. Forma e strategjisë do të varet kryesisht nga procesi i formulimit dhe nga fakti se kush merr pjesë dhe pikëvështrimet e kujt dominojnë.

Disa parime duhet të udhëheqin punën formuluese, të pavarur nga procesi dhe pjesëmarrësit:

1. Edhe pse qëllimi i gjithmbarshëm për Kosovën duhet të jetë përmirësimi i aftësive njerëzore, mënyra më e mirë për ta arritur atë është përmes rritjes ekonomike të qëndrueshme³. Pas daljes nga faza emergjente e pas konfliktit, Kosova nuk mund të arrijë ngritjen e aftësive njerëzore duke u mbështetur në politikat rishpërndarëse, kur nuk ka shumë për të rishpërndarë. Ekziston një konsensus i përbashkët tani që ngritja është mjeti më i mirë për uljen e varfërisë dhe për përmirësimin e standardit jetësor⁴.

2. Në një strategji për rritje duhet të marrë parasysh faktin se resurset e Kosovës janë shumë të limituara dhe duhet të përdoren në mënyrë efektive në fushat ku kthimet janë më të larta. Shumë strategji të zhvillimit ekonomik apo të rritjes bëjnë një punë të mirë në vlerësimin e dobësive në një ekonomi, por jo edhe aq të mirë në vlerësimin e rrënjëve të dobësive dhe zgjidhjet e rekomanduara⁵. Këtu shpesh ofrohen parime të gjera dhe abstrakte, siç është qeverisja e mirë, sundimi i ligjit, të drejtat pronësore, makroekonomia, politikat e qëndrueshme fiskale, të cilat do të ishin të padobishme nëse nuk shndërrohen në politika operacionale. Gjithashtu, zgjidhjet nganjëherë janë tepër larg nga rrethanat vendore dhe rrjedhin kryesisht nga përvojat e vendeve të tjera. Përderisa përvojat e vendeve të tjera janë të dobishme shumicën e herëve, rëndësia e kontekstit vendor trumbeton diçka tjetër.

2 Shiko dokumentet e politikave të Grupit të Strategjisë Ekonomike dhe Identifikimit të Projektit (ESPIG), Nr. 1 dhe 2, në faqen e Shtyllës së BE-së www.euinkosovo.org.

3 Një definicion i mirë i aftësive njerëzore është dhënë nga Amartya Sen në "Zhvillimi si Liri". Ky definicion përfshin gjërat, siç janë standardet e mira të jetesës, të arriturat e mira arsimore dhe shëndeti, siguri dhe përfshirja në vendimmarrje.

4 Raporti i Zhvillimit Botëror 2005, Banka Botërore.

5 "Diagnoza e rritjes (ngritjes)", Dani Rodrik, Ricardo Hausmann dhe Andres Velasco, Universiteti i Harvardit

3. Strategjia e rritjes duhet të bëjë një punë të mirë në caktimin e prioriteteve për intervenim. Nëse marrim çfarëdo strategjie të zhvillimit nacional që është formuluar deri më tani, sipas të gjitha gjasave do të shohim se për secilën simptomë (kufizim të rritjes) ekziston zgjidhje (reformë). Kështu që, vendet ballafaqohen me një listë të gjatë të reformave, nga e cila ata zgjedhin ato të cilat janë më të arritshme në aspektin politik, administrativ dhe financiar. Njësoj si marinari kur mbyll vrimat në anijen e tij dhe, në anën tjetër, një vrimë tjetër hapet, edhe shtetet vazhdojnë reformën, por lista e reformave vetëm sa shkon e rritet.

4. Sfida më e madhe në zhvillim është diagnoza e duhur. Kokë dhembja mund të vijë si rezultat i shumë sëmundjeve. Mjeku i mirë nuk jep dhjetëra barna, duke shpresuar se një nga ata do ta ndalojë sëmundjen. Ai në mënyrë të kujdesshme identifikon rrënjën e problemit dhe i qaset atij. Nëse sëmundja shpërndahej edhe në vendet e tjera, ai (mjeku) duhet të merret edhe me këto. Shmangia nga rrënjët dhe marrja me fushat që janë më pak kritike do të ishte një rrugë drejt dështimit.

Prandaj, vlerësimi i pengesave të rritjes është kritik, por po aq kritik është edhe caktimi dhe qasja ndaj intervenimeve. Qëndrimi i përgjithshëm se çdo reformë është e mirë është një qëndrim i gabuar. Ajo që e bën këtë qëndrim edhe më të keq është fakti se vendet si Kosova kanë resurse të kufizuara, duke përfshirë edhe kapitalin politik. Ato (resurset) duhet të vendosen aty ku ndikimi është më i madh.

Zakonisht, ndikimi i intervenimeve është më i madh atëherë kur si cak i kemi ato pengesa që janë më të mëdha. Pasi të largohen pengesat më të mëdha, pastaj kalojmë tek pengesa tjetër dhe merremi me të. Nëse pajtohemi me kombinimin e katër parimeve të radhitura më lart, atëherë strategjia e zhvillimit ekonomik të Kosovës përqendrohet në identifikimin e vetëm disa pengesave dhe në heqjen e tyre përmes intervenimeve të kujdesshme.

Në këtë kontekst, ky dokument ka dy qëllime:

1. Të theksojë nevojën dhe urgjencën për një vizion dhe strategji të zhvillimit ekonomik për Kosovën;

2. T'i kontribuojë debatit të tanishëm të zhvillimit duke argumentuar se transformimi strukturor që i duhet Kosovës mund të arrihet përmes dy veprimeve: (i) mobilizimi i sektorëve tradicionalë, siç janë minierat dhe energjia, dhe (ii) inkurajimi i aktiviteteve jotradicionale që duhet të zbulohen. Ringjallja e sektorëve tradicionalë është një rrugë me më pak rreziqe për krijimin e resurseve që janë të nevojshme për promovimin e aktiviteteve jotradicionale. Përveç kësaj, ngritja e aktiviteteve tradicionale dhe jotradicionale kërkon heqjen e barrierave kryesore që pengojnë procesin e transformimit, veçanërisht në arsim, aspektin institucional dhe promovimin e investimeve.

2. Potencialet e rritjes

Në krahasim me vitet e para të pasluftës, ekonomia e Kosovës është duke u degëzuar dhe kjo është tregues i vështirësive për të krijuar një ngritje të qëndrueshme. Një ringjallje afatgjate kërkon mobilizimin e të gjitha burimeve të brendshme të zhvillimit (ngritjes).

Potenciali në sektorët tradicionalë të minierave, energjisë dhe bujqësisë është i madh dhe duhet bërë përpjekje, veçanërisht përmes procesit të privatizimit, që të nxirret sa më shumë zhvillim nga këto. Sidoqoftë, në aspektin afatgjatë nevojiten burime të tjera për të mbajtur një standard të lartë të jetesës. Këto burime të tjera duhet të zbulohen ende nga ndërmarrësit vendorë, përmes procesit duke gabuar e mësuar. Qeveria e ka rolin kyç në avancimin e zbulimit të aktiviteteve jotradicionale, të cilat kanë në vete rreziqe më të mëdha sesa ato tradicionale.

Përcaktuesi më i afërm i zhvillimit është investimi, meqë krijon vende pune dhe prodhim. Edhe pse lidhja e supozuar e drejtpërdrejtë e investimit me ngritjen dhe zhvillimin, në një mënyrë, është diskredituar kohëve të fundit nga dëshmitë e reja empirike, megjithatë, pranohet se ngritja do të dështojë në mungesë të investimeve. Me fjalë të tjera, investimi është një kusht i domosdoshëm por jo i mjaftueshëm për ngritje.

Ndihmat masive nga jashtë në periudhën e pasluftës dhe paratë e dërguara nga diaspora kosovare ishin qenësore për ta nxjerrë Kosovën nga gjendja e vështirë njerëzore dhe ekonomike, që ishte thelluar mjaft shumë kah fundi i viteve të 90-ta. Rindërtimi dhe stabilizimi vazhduan mjaft shpejt dhe dhanë rezultate të qarta në shumë fusha, duke përfshirë zbutjen e varfërisë dhe zhvillimin ekonomik.

Sidoqoftë, kuotat e investimit në Kosovën e pasluftës kanë qenë shumë të ulëta krahasuar me standardet rajonale dhe botërore. Fondi Monetar Ndërkombëtar ka llogaritur se investimet në sektorin vendor në vitin 2003 ishin 22.3% dhe vlerësimi për vitin 2004 ishte 22.8%⁶. Edhe këto shifra e nënvlerësojnë seriozitetin e situatës, sepse një pjesë e madhe e investimeve nuk është kanalizuar në aktivitete produktive por ishte drejtuar nga gama e ndërtimeve të pasluftës dhe shërbimeve për komunitetin e donatorëve (të dyja këto janë në zvogëlim e sipër).

⁶ "Kosova - Drejtimi i politikave drejt ngritjes dhe zhvillimit", Raport i FMN-së, nëntor 2004.

Për më shumë, përderisa kuotat fillestare të zhvillimit ishin mjaft të larta, si edhe rezultati i bazës së vogël prej së cilës filloi rindërtimi, burimi i ripërtëritjes ishte tepër i ngushtë⁷. Shumica e zhvillimit erdhi nga dy sektorë: ndërtimi kaloi nëpër një gamë masive, si reagim ndaj dëmtimit të shtëpive gjatë konfliktit⁸, dhe tregtia lulëzoi si rezultat i harxhimit të konsumuesve dhe donatorëve në rritje që financohej me të madhe nga ndihma e jashtme dhe paratë e dërguara nga diaspora.

Jo befasisht, ky lloj i ngritjes së vogël u tregua i paqëndrueshëm dhe nga viti 2002 ekonomia ka qenë në lëvizje më të ngadaltë. Derdhja e ndihmës së jashtme është zvogëluar dhe vlugu i ndërtimeve dhe sektorëve të shërbimit ka rënë. Ngritja nuk ka vazhduar në fushën e bujqësisë dhe sektorët e prodhimit, fusha në të cilat aktiviteti i intensifikuar ekonomik është më i qëndrueshëm dhe ku përfitimet janë të shpërndara më mirë.

Shumica e aktiviteteve ekonomike tani janë koncentruar në sektorin e bujqësisë dhe të shërbimeve. Pjesa e bujqësisë në ekonomi është e madhe (një e treta) dhe është ngritur në dekadën e fundit, jo për shkak të zgjerimit të prodhimit bujqësor, por si rezultat i kolapsit të sektorit prodhues e veçanërisht dobësimi të ndërmarrjeve shoqërore dhe publike. Sektori i shërbimeve është i orientuar drejt tregtisë dhe shërbimit në një masë të madhe (restorantet, shërbimet e taksive, hotelet etj.). Prodhimi nuk ka suksese për mburrje. Minierat janë shkatërruar në masë të madhe dhe as sektori i energjisë nuk është i qëndrueshëm.

Bilanci negativ i tregtisë pasqyron dobësinë e të gjithë sektorëve në ekonomi. Në vitin 2003 eksportet ishin në 1.9% të Bruto Prodhimit Vendor dhe mbuluan vetëm 3.7% të importeve. Importet e ushqimit përbënin 33.8% të importit të mallrave dhe deficitin primar i tregtisë si përqindje e deficitit të gjithmbarshëm të tregtisë ishte 60%.

2.1 Aktivitetet tradicionale

Potenciali për ngritje në fushat tradicionale është qenësor dhe bujqësia, energjia dhe minierat, të shtytura nga privatizimi, ka gjasë të jenë qenësore për të nisur makinën e ngritjes (zhvillimit). Kosova dikur kishte një rrjet të eksportimit të prodhimeve bujqësore, tani ka një bilanc negativ në këtë sektor. Mineralet dhe energjia ishin kyç në ekonomi dhe kanë gjeneruar një shumë të rëndësishme të të ardhurave, si dhe kanë krijuar shumë vende pune. Për shkak të pranisë së resurseve dhe, në veçanti, për shkak të lehtësirave të nxjerrjes së linjtit, Kosova ka një përparësi krahasuese në miniera dhe energji.

⁷ Vlerësimi i fundit i zhvillimit nga Banka Botërore për vitin 2002 është 1.2% ("Raportimi mujor ekonomik mbi Kosovën", prill 2005). FMN ka rishikuar vlerësimin e vet për kuotat e ngritjes (zhvillimit) disa herë. Përkundër kësaj pasigurie statistikore, ekziston një konsensus që Kosova ka pasur një ngritje në shifra dyshifrore në vitet 2000 dhe 2001.

⁸ Raporti i USAID-it "Vlerësimi i të drejtave pronësore në Kosovë", mars 2004, e saktësoi numrin e shtëpive të shkatërruara gjatë luftës në Kosovë deri në 300.000.

2.1.1 Bujqësia

Sa më lart që të lëviz Kosova në zinxhirin e vlerës së shtuar bujqësore, aq më i lartë do të jetë niveli i aktivitetit ekonomik që mund ta mbajë ajo. Blegtoria është një aktivitet bujqësor që përfshin relativisht pak vlerë të shtuar në krahasim me, për shembull, procesimin bujqësor. Edhe brenda blegtorisë disa aktivitete kanë më shumë vlerë të shtuar sesa disa të tjera. Duke marrë parasysh hapësirën e vogël të tokave, kultivimi i frutave dhe perimeve përfshin më shumë vlerë të shtuar sesa mbledhja e drithërave.

Duke marrë në konsideratë nivelin e ulët momental të prodhimtarisë në bujqësi, potenciali për përmirësim është i madh. Potenciali i lartë i Kosovës për përfitime nga prodhimtaria duhet të përdoret për të stimuluar ngritje në një afat të shkurtër. Për zhvillimin e sektorit bujqësor janë të rëndësishme dy gjëra:

1. Fermerët kanë nevojë për përkrahje në fushat diverse, siç është marrja e teknologjisë bujqësore nga vendet fqinje, qasja në financa, marketingu dhe shpërndarja, cilësia dhe siguria e produkteve, koordinimi dhe formimi i asociacioneve.

2. Konsolidimi i tokës duhet të ndodhë para se të rritet prodhimtaria. Madhësia mesatare e fermave është 2.2 hektarë, e ndarë në mesatarisht 8 parcela⁹ dhe, si rrjedhojë, prodhimi nuk shitet. Edhe pse emërimi dhe regjistrimi i tokave është larg nga përsosmëria, këta nuk janë faktorët kryesorë që e mbajnë tokën e fragmentarizuar. Blegtorët e shohin tokën si mundësi të vetme për të siguruar mbijetesë. Toka është mekanizëm i mbijetesës. Me vetëm disa mundësi jashtë sektorit bujqësor, fermerët janë duke u treguar të arsyeshëm, duke mos e shitur tokën e tyre.

Prodhimtaria e shtuar në bujqësi do të shoqërohet me një lëvizje në fuqinë punëtore. Një ndarje e rëndësishme e fuqisë punëtore do të ketë një lëvizje nga bujqësia në sektorin e prodhimit dhe shërbimeve (dy të tretat e popullatës janë të punësuar në sektorin e bujqësisë). Copëzimi (fragmentimi) i tokës dhe pjesa e madhe e popullatës e përfshirë në bujqësi janë të ndërlidhura. Në mungesë të një sektori të shëndoshë të prodhimit, duke vënë kërkesa ndaj tregut të punës dhe tokës, transformimi strukturor nuk do të ndodhë dhe rëndësia sociale e mbijetesës bujqësore do të mbetet qenësore.

Në nivelin politik, Kosova ka një zgjedhje midis një regjimi mbrojtës me pengesa tregtare apo subvencione të mëdha prodhuese sikur në Politikën e Përbashkët Bujqësore të Bashkimit Evropian, apo një agjendë të liberalizuar që e vë sektorin bujqësor në konkurrencë me akterët regionalë dhe me BE-në. Mbrojtja e prodhimeve bujqësore përmirëson gjasat e suksesit për fermerët por e vë një ngarkesë të madhe tek konsumatorët dhe procesuesit bujqësorë, në rastet e tarifave doganore apo tatimpaguesve në rastet e subvencioneve. Liberalizimi i vazhdueshëm rajonal në Evropën Juglindore është një mënyrë për të krijuar një fushë të konkurrimit të kufizuar, në të cilën prodhuesit kosovarë mund të marrin përvojën që është e nevojshme për të mbuluar tregun e gjerë evropian.

⁹ "Libri i Blertë i Kosovës", Dokument Strategjik i Ministrisë së Bujqësisë, Ambientit dhe Zhvillimit Rural, maj 2003.

2.1.2 Energjia

Rëndësia e sektorit të energjisë është e dyfishtë: (i) sigurimi i përmirësuar i furnizimit me energji elektrike do të përkrahte zhvillimin e gjithmbarshëm të sektorit privat; dhe (ii) eksporti i energjisë në tregun rajonal mund të gjenerojë të ardhura shtesë. Kosova ka një përparësi në prodhimin e energjisë nga linjiti. Rezervat e linjtit vlerësohen të jenë të mëdha (rreth 14.3 miliardë tonë). Çmimi i prodhimit të energjisë nga qymyri në Kosovë është më i ulët në rajon (0.62 euro/GJ, në krahasim me 0.88 euro/GJ për Bullgarinë dhe 1.34 euro/GJ për Serbinë dhe Malin e Zi),¹⁰ për shkak të lehtësive në mihjen (një kuotë mesatare prej 1.7 m³ e tokës për 1 ton qymyri) dhe cilësisë së mirë të qymyrit (6.28-9.21 MJ/kg)¹¹. Çmimi i ulët i prodhimit të energjisë, i kombinuar me një ngritje të pritur të kërkesës për energji elektrike në rajon, si dhe dalja e tregut të përbashkët të energjisë pas Memorandumit të Athinës në vitin 2002, e ka vënë Kosovën në një pozitë të favorshme kundrejt vendeve të tjera të Tregut Rajonal të Energjisë.

Studimi i Investimit për Prodhim, i iniciuar nga Komisioni Evropian dhe i bërë nga Banka Botërore, konfirmon se Kosova ka një potencial të madh për prodhimin dhe eksportin e energjisë.¹² Sipas raportit, me investime të përshtatshme Kosova mund të shtojë edhe 4,000 MW në kapacitetin e vet dhe do të mund të bëhej një eksportues i madh në tregun rajonal, që është në zgjerim.

Sidoqoftë, për t'i shfrytëzuar këto mundësi në sektorin e energjisë, Kosovës i nevojitet një përmirësim i kornizës ekzistuese institucionale dhe ligjore. Përderisa është bërë përmirësim me krijimin e Ministrisë së Energjisë dhe Minierave, Zyrës së Rregullatorit të Energjisë dhe Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, ka ende punë për t'u bërë në lidhje me ligjet dhe rregulloret ekzistuese.¹³

2.1.3 Minierat

Sektori i minierave paraqet mundësi për eksport dhe për përfitimin e monedhave të huaja dhe, në rast të privatizimit të shpejtë, mund të përdoret për të përkrahur ngritjen në një afat të shkurtër. Në vitet e 90-ta, industria është zvogëluar si rezultat i neglizhencës dhe mungesës së investimeve kapitale. Përveç linjtit, Kosova është e pasur me plumb, zink, nikel dhe magnez. Sidoqoftë, sektori i minierave paraqet tri probleme serioze. Së pari, riaktivizimi i minierave është me plot vështirësi dhe në shumë vende ka dështuar. Prandaj, është joreale që minierat në Kosovë të arrijnë nivelin që kanë pasur në kohën e ish-Jugosllavisë. Së dyti, për të ringjallur sektorin e minierave nevojiten investime të mëdha kapitale. Së treti, minierat në kohën moderne janë investim kapital, kështu që përfitimet në tregun e punës do të ishin të papërfillshme dhe problemi i papunësisë do të mbetej përsëri i pazgjidhur.

10 Burimi: "REBIS: GIS - Raporti Final", PwC Konzorciumi, Financuar nga Programi CARDS i BE-së, 31 dhjetor 2004.

11 "Strategjia dhe politika mbi energjinë në Kosovë", Dokumenti i Bardhë, Zyra e Përbashkët e UNMIK-ut dhe IPVQ-së për Energji, shtator 2003.

12 "REBIS: GIS - Raporti Final", PwC Konzorciumi, financuar nga Programi CARDS i BE, 31 dhjetor 2004.

13 IPA Energy Consulting and Norton Rose, Projekti II i Ndhmës Teknike në Sektorin e Energjisë, 25 mars 2005.

2.1.4 Mundësitë dhe rreziqet

Mobilizimi i aktiviteteve tradicionale do të jetë qenësor për ekonominë e Kosovës në një afat të shkurtër dhe të mesëm. Bujqësia mund të shfrytëzohet për të dhënë rezultate në një afat të shkurtër (disa vite) dhe minierat dhe energjia në një afat të mesëm (pesë deri në dhjetë vite). Sidoqoftë, këtu përfshihen edhe sfida:

- Investime të mëdha nevojiten për të ringjallur sektorin e energjisë dhe të minierave dhe, në këtë aspekt, investimet direkte nga jashtë janë të një rëndësie qenësore. Kushtet e nevojshme për të tërhequr investitorët e huaj duhet të mbahen në mend.
- Në bujqësi, akterët e tjerë kanë konsoliduar pozitat e tyre dhe kanë marrë pozita më të dukshme. Me subvencione të forta dhe intensive në Bashkimin Evropian, blegtoria krijon suficit që lë pak hapësirë për konkurrim. Akterët rajonalë, siç janë Bullgaria dhe Rumania, kanë avancuar sektorët e tyre të bujqësisë në formë të mirë dhe së shpejti do të bëhen përfituese të fondeve të BE-së.¹⁴
- Mbështetja kryesisht vetëm në minerale dhe në energji nuk është një strategji e mirë. Çmimet e artikujve të përdorimit të gjerë janë të paqëndrueshme dhe në rastin me mineralet trendi afatgjatë është në zvogëlim e sipër.

Një stimulim i shpejtë do të vijë nga procesi i ringjallur i privatizimit. Privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore do të ndihmojë në shpëtimin e bërthamave industriale që kanë një potencial të vërtetë ekonomik. Procesi i privatizimit gjithashtu ka për qëllim tërheqjen e investimeve direkte nga jashtë, jo vetëm për shkak të teknologjisë superiore dhe shkathtësive menaxhuese që vijnë me të, por si shenjë e një ambienti të mirë të punës për investitorët e tjerë të interesuar.

2.2 Aktivitetet jotradicionale

Meqë sektorët tradicionalë mund ta përshpejtojnë ngritjen, por nuk mund ta mbajnë atë në një afat të gjatë, zhvillimi i aktiviteteve të reja bëhet qenësor. Këto aktivitete mund të quhen jotradicionale, sepse Kosova duhet t'i zbulojë ato ende. Cilat do të jenë këto aktivitete? Askush nuk e di me siguri, sepse zhvillimi i aktiviteteve jotradicionale është një proces i zbulimit nga mësimi dhe gabimi ose vetëzbulimi.

Me “zbulimin e aktiviteteve të reja” nuk nënkuptohen patjetër zbulimet dhe risitë, por edhe adoptimi fitimprurës i teknologjive të vendeve të tjera. Duke marrë parasysh shkathtësitë e tyre të kufizuara, hulumtimet e pakta dhe buxhetin zhvillimor, vendet si Kosova kanë pak hapësirë për risi dhe zbulime. Nëse një teknologji kryen punë në një

¹⁴ Politika e Përbashkët Bujqësore e BE-së kanalizon një pjesë të madhe të fermerëve të shteteve anëtare të BE-së. Si shtesë, fondet strukturore drejtohen në vendet e pazhvilluara.

vend, nuk ka garanci se do të kryejë punë në mënyrë të dobishme edhe në vendet e tjera. Adoptimi i teknologjisë është po aq i dobishëm dhe ka po aq rrezik sa edhe zbulimet e reja.

Në përgjithësi, zbulimi i aktiviteteve të reja e shpie ekonominë në fusha më të larta të vlerës së shtuar. Për më shumë, për vendet me një bazë shumë të ngushtë të prodhimit, siç është Kosova, procesi i zbulimit është mënyra e vetme përmes së cilës ekonomia mund të diversifikohet. Diversifikimi është i nevojshëm sepse: (i) ruan ekonominë nga tronditjet e jashtme që e godasin bazën e komoditetit të saj; (ii) e largon presionin e tepërt nga ndërmarrjet ekzistuese, që shpie në kufijtë e përfitimit më të lartë dhe investimet e shtuara; dhe (iii) krijon një platformë për një numër më të madh të zbulimeve të ardhshme dhe ideve mbi investimet.

Tani është e qartë se ndërmarrësit e Kosovës, qoftë ata vendorë apo ndërkombëtarë, tregojnë relativisht pak interesim në investime në sfera të reja. Në vend të gjurmimit të mundësive të reja për investim, investitorët në Kosovë janë përqendruar në sektorët tradicionalë dhe janë duke e gjymtuar fitimin e njëri-tjetrit. Në aktivitetet ekzistuese (tradicionale) konkurrenca është e fortë.¹⁵ Sidoqoftë, me lidhje të forta me botën perëndimore, që janë themeluar nga mijëra emigrantë kosovarë, veçanërisht në Gjermani dhe Zvicër, nuk duhet të ketë mungesë të madhe të shkathtësive ndërmarrëse. Pra, çfarë po e mban investimin në aktivitetet e produktivitetit të ulët?

Pengesa kryesore në kërkesat e investimeve në aktivitetet e reja vjen nga profitabiliteti i pasigurt dhe rreziku i madh sesa që është në rastet e investimeve në aktivitetet tradicionale. Për të zbuluar çmimin e produktit të ri dhe fitimin, dikush duhet të provojë që ta bëjë prodhimin e atij produkti. Nëse investimi është i suksesshëm, atëherë investitorë të tjerë do të kopjojnë shumë shpejtë idenë pa rreziqe të mëdha dhe, si rrjedhojë, çmimi do të zvogëlohet në dëm të investitorit fillestar, i cili nuk e ka marrë atë që e ka investuar ende. Nëse dështon investimi, investuesi fillestar duhet të bartë plotësisht pasojat e dështimit.

Zbulimi i fitimit në aktivitetet e reja është në dobi të shoqërisë si tërësi, ndërsa çmimi i dështimit në procesin e zbulimit bartet nga individi. Kjo shpërputhje midis kthimit tek shoqëria dhe shpenzimeve të investuesit do të rezultojë me mungesë të investimeve në aktivitete të reja – një rast klasik i dështimit të tregut. Qeveria mund ta sjellë këtë nivel të investimit në një nivel optimal, duke i përkrahur (drejtpërdrejtë dhe tërthorazi) aktivitetet e reja në sferat jotradicionale. Arsyeimi është se këto aktivitete krijojnë efektin pozitiv të shpërndarjes (zgjerimit) në shoqëri dhe për këtë ato duhet të shpërblehen.

Për më shumë, investitorëve iu nevojiten kushte të caktuara para se të fillojnë veprim-

¹⁵ “Vlerësimi i klimës së investimeve”, nga Banka Botërore, 2003, zbuloi se “80% e ndërmarrjeve konkurrojnë në tregun kryesor të prodhimit të tyre me më shumë se 20 ndërmarrje të tjera dhe gati gjysma e respondentëve raportuan për më shumë se 20 furnizues. Tri të katërtat e ndërmarrjeve kontrollojnë më pak se 5 për qind të tregut, ndajnë linjën e tyre kryesore të prodhimit. Përfundimisht, dy të tretat e të gjitha ndërmarrjeve treguan se, nëse do të ngrinin çmimet e tyre për 10%, konsumatorët e tyre do të blinin më pak sasi apo nuk do të blinin fare”.

in. Kjo nuk ndërlidhet vetëm me infrastrukturën fizike, arsimin, por edhe me përkrahjen e institucioneve, si për shembull rrjetet shpërndarëse dhe propaganduese, furnizuesit dhe blerësit, hulumtimet dhe zhvillimi, ndihma në dogana, deponimi dhe reklamimi. Investimi i tij do të jetë fitimprurës vetëm nëse ekzistojnë këto shtesa. Nganjëherë firmat arrijnë koordinimin vetëm (për shembull duke themeluar një bord eksportimi apo duke themeluar një institucion të përbashkët të hulumtimeve dhe të zhvillimit), ndërsa në rastet e tjera vetëm qeveria do të mund të ofrojë investimet e kërkuara.

3. Kufizimet e rritjes¹⁶

Duke qenë të ulëta në krahasim me standardet botërore, kursimet nuk duken të jenë kufizim kryesor i rritjes, thjesht për shkak se tashmë ka shumë likuiditet në sistemin bankar dhe kamatat në përgjithësi nuk janë jashtëzakonisht të larta.

Kualiteti prezent i arsimit dhe shkathtësive të biznesit në përgjithësi paraqet një frenim në kërkesën e investimit, kurse, me përjashtim të energjisë, infrastruktura nuk prezanton një bllokim të kufizuar për zhvillimin e sektorit privat.

Rregullimi institucional nuk është ende pengesë, por një ekonomi e zgjeruar do ta rrisë shpejt atë, nëse nuk ndërmerren masat mbështetëse.

Promovimi i investimit është i dobët, por promovimi i investimit është një ndër instrumentet më të rëndësishme në zbulimin e aktiviteteve jotradicionale.

Ne fillojmë hulumtimin e kufizimeve të rritjes me shqyrtimin e pesë përcaktuesve të afërt të përgjithshëm të investimit:

- (I) kursimet,
- (II) arsimi,
- (III) infrastruktura,
- (IV) mjedisi institucional dhe
- (V) promovimi i investimit.

Për secilin prej tyre ne përcaktojmë nëse ata janë kufizim i detyruar në investim dhe në çfarë mase e ndalin rritjen. Derisa kursimet janë faktor i furnizimit klasik të investimit, faktorët tjerë kanë të bëjnë me anën e kërkesës të investimit. Promovimi i investimit, në veçanti, adreson pengesat për të zhvilluar aktivitetet e reja siç u paraqitën më lartë.

3.1. Kursimet

Në pamjen e parë, duket se kursimet janë ato që fajësohen për kamatat e ulëta në Kosovë. Në pesë vitet e fundit kursimet vendore kanë qenë shumë negative (në mes -35 dhe -25%). Këto janë tarifa jashtëzakonisht të ulëta, madje me standardet e vendeve

¹⁶ Ky seksion shfrytëzon një kornizë të rritjes të krijuar nga Rodrik, Velasco dhe Hausmann të Universitetit të Harvardit në punimin e tyre "Hulumtimi i Rritjes", mars 2005, Universitetit të Harvardit, (<http://ksghome.harvard.edu/~drodrik/barcelonafinalmarch2005.pdf>).

të zhvilluara. A s'është tarifa e kursimit drejtpërsëdrejti e ndërlidhur me investimin? A s'duhet të adresohen tarifat e kursimeve me politikat e përqendruara kryesisht në sektorin financiar dhe ndërmjetësimin financiar? Jo, padyshim! Tarifat e ulëta të kursimeve mund të jenë shenjë e tarifave të ulëta të investimit.

Edhe pse Kosova ka një shkallë të ulët të kursimeve, shumë indikatorë na bëjnë vigjilentë se kjo nuk është një ndër kufizimet më të detyrueshme. Bankat komerciale kanë shumë fonde në dispozicion, një pjesë e të cilave ato i kanë investuar jashtë vendit dhe kanë qenë të përmbytura me likuiditet në një kohë kur tarifat e investimit të sektorit privat kanë qenë më të ulëtat në botë. Ato mund të tërheqin depozitat me kamata relativisht modeste, kurse kamatat e huas nuk janë jashtëzakonisht të larta.¹⁷ Kosova është ndër dhjetë vendet më të mira me hyrje më të mëdha të parave të dërguara për person, por shumica e këtyre të hollave financojnë konsumimin. Një shëtitje përreth ndonjë qyteti kryesor zbulon një invazion në ndërtim, që mund të dekurajojë çdonjërin që mendon se Kosovës i mungojnë fondet e investimit.

Për dallim, kërkesa e ulët duket të jetë një ndër kufizimet më serioze. Në parim, furnizimi i kursimeve dhe kërkesa e investimit është OK, por kjo nuk është një përdorim efikas i resurseve të pamjaftueshme dhe kapitalit politik. Imagjinoni nëse disi tarifa e kursimeve në Kosovë u rrit në një nivel të ndjeshëm dhe fondet e investimit ishin të arritshme pa vështirësi. A do t'i zgjidhë kjo problemet? Pothuajse me siguri jo! Në të kundërtën, kjo mund të shkaktojë probleme shtesë, sikurse përkeqësimi i bilancit të sektorit bankar dhe një rritje në vlerën e moskryerjes së huave (një fenomen mirë i përjetuar nga disa donatorë në periudhën e rindërtimit).

Kështu, nga pikëpamja e politikës ajo ka më tepër kuptim për t'u përqendruar në kërkesën për fondet e investimit, e cila më pastaj do të bëjë presion (përmes kamatave) në sektorin financiar për të mobilizuar më tepër kursime.

3.2. Arsimi

Arsimi është përcaktues kyç i investimit dhe, në vijim, i rritjes ekonomike. Njerëzit me shkathtësi më të mira mesatarisht prodhojnë më tepër dhe ide më të mira të investimit dhe janë shumë më të suksesshëm në përgjegjësitë e tyre. Lehtësimi i përtëritjes së edukimit dhe adoptimi i teknologjive të huaja e rrisin produktivitetin e punës. Për më tepër, arsimi është një faktor i rëndësishëm të cilin investitorët e huaj e marrin në parasysh kur vendosin se ku duhet investuar.

Synimi vendimtar i një sistemi edukativ është që të përgatisë individë të kualifikuar, të cilët mund të përgjigjen në kërkesën e ekonomisë për punë të shkathtë. Shkathtësitë dhe kualifikimet që pjesëmarrësi i përfiton përmes arsimit janë fillimisht të varura në infrastrukturë, si dhe në motivimin që e bën mësimin efektiv një aktivitet tërheqës.

¹⁷ "2004 Raporti Vjetor", Autoriteti Bankar dhe i Pagesave i Kosovës, 2004.

Sistemi edukativ i Kosovës ka qenë në rënie serioze që nga viti 1989. Gjatë viteve të '90-ta, një sistem i strukturave joformale u paraqit krahas institucioneve zyrtare të udhëhequra nga qeveria jugosllave, dhe shkollimi zuri vend në shtëpitë private dhe u shpërnda në një mënyrë jo të koordinuar dhe jo të standardizuar. Kryesisht si rezultat i kësaj “dekade të humbur”, sot ekziston një mungesë e shkathtësive në shumë fusha, veçanërisht në shkencat ekzakte, inxhiniering, jurisprudencë dhe në shërbime të biznesit.

Derisa është arritur shumë progres, gjendja është shumë larg nga stabiliteti, veçanërisht në nivelin terciar. Nga komuniteti dhurues janë bërë përpjekje për rikrijimin e sistemit dhe për rehabilitimin e infrastrukturës, që të plotësohet boshllëku i një dekade të gjatë. Megjithatë, dhuruesit e mëdhenj të investimeve në infrastrukturën e shkollës nuk kanë qenë në përputhje me përmirësimet ekuivalente në kualitetin e dhënies së mësimin. Pamjaftueshmëria dhe kualiteti i mësimdhënësve, planprogrami, tekstet shkollore, kompjuterët, laboratorët dhe mjetet tjera plotësuese janë pengesë kryesore në këtë sistem.

Kualiteti i mësimdhënies në nivelin e universitetit ka një ndikim të drejtpërdrejtë në kualitetin e studentëve.¹⁸ Universiteti i Prishtinës furnizon me mijëra të diplomuar çdo vit, por duket se shkathtësitë e tyre në shumë raste nuk përputhen me nevojat e tregut. Mungesa e shkathtësive, e raportuar nga Banka Botërore dhe studimet e USAID-it,¹⁹ në një kohë kur ekziston një numër shumë i madh i të papunësuarve me tipin e shkathtësive të kërkuara në treg, tregon se problemi i kualitetit është shumë më i ashpër sesa problemi i kuantitetit. Për t'u përgjigjur në kërkesën për shkathtësitë e kualitetit të lartë, disa universitete private kanë ofruar diploma në administratën e biznesit dhe në shkollat e licencuara, duke ofruar edhe kurse të panumërta të gjuhëve të huaja. Kualiteti i të diplomuarve nga shkollat private është në mënyrë të dukshme më i lartë.

Arsimi është lëmi politike shumë e rëndësishme, e cila kërkon vetëdijesim adekuat dhe resurse nga qeveria dhe akterët tjerë përkatës:

(I) Arsimi në vetvete, i ndarë nga konteksti i marrëdhënies së tij me investimin e rritjes, është një synim virtuoze, sepse ai rrit aftësitë dhe shton dinjitetin njerëzor.

(II) Marrëdhënia ndërmjet arsimit dhe investimit është dyanësore: arsimi ndikon investimin (furnizimi i shkathtësive çon deri tek idetë e investimit) dhe investimi ushtron një forcë tërheqëse në arsim. Kjo marrëdhënie nënvizon nevojën për t'i konsideruar investimin dhe edukimin si të pandara (harxhimi i rritur në edukim duhet të shkojë dorë pas dore me përqendrim të rritur në investime në sektorët produktivë). Këto fenomene e mbështesin argumentin për një përqendrim më të prerë në inves-

¹⁸ Sipas një studimi të Riinvest-it të vitit 2004 për sektorin e edukimit, kualiteti i mësimdhënies në shkollat fillore dhe ato të nivelit të mesëm është konsideruar më pak problematik (“Zhvillimi edukativ dhe ekonomik i Kosovës”, Raporti i Riinvest-it, muaji shkurt i vitit 2004).

¹⁹ Banka Botërore “Vlerësimi i klimës së investimit”, viti 2003; Banka Botërore, Memorandumi ekonomik i vendit i vitit 2004; dhe “Studim i kufizuar”, Projekti Mbështetës Grupor dhe i Biznesit të Kosovës, USAID, muaji prill i vitit 2005.

tim.

(III) Kualiteti i edukimit varet në kërkesën për shkathtësitë nga sektorët e prodhimit. Presionet nga ana e kërkesës duhet të monitorohen me kujdes dhe duhet të ndërmerren veprime të shpejta për t'i lehtësuar ato me furnizim të rritur. Sektori privat mundet me siguri të heqë disa nga këto presione, mirëpo qeveria duhet të ndihmojë, veçanërisht në kapacitetin e ngushtë. Një opsion tjetër është që të zgjerojë numrin e studentëve, të cilët studiojnë jashtë vendit, duke krijuar programe që sigurojnë bursa dhe informata lidhur me universitetet e jashtme.

3.3. Infrastruktura

Furnizimi i dobët me energji është një ndër faktorët më kufizues për krijimin e ambientit të përshtatshëm. Në të gjitha studimet e biznesit të bëra pas konfliktit, energjia paraqitet në mënyrë të qëndrueshme në kulm të listave të problemeve, siç është e vërtetuar nga sipërmarrësit.²⁰ Përkundër përmirësimit të fundit të situatës, reduktimet janë ende të shpeshta dhe, në shumë raste, të paparashikueshme. Problemet në sektorin e energjisë paraqesin kufizime për zhvillimin e biznesit për shumë arsye:

- Ato e kanë ulur produktivitetin përmes prishjes së procesit të prodhimit.
- Burimet alternative të energjisë rrisin koston e prodhimit dhe i bëjnë kompanitë jokonkurruese në vendin e vet dhe në tregjet e huaja.
- Kyçjet në rrjetin e energjisë në Kosovë kërkojnë më shumë kohë tepër sesa në ndonjë vend tjetër në rajon.
- Furnizimi joefikas e rrit çmimin e energjisë, e cila drejtpërsëdrejti ndikon në çmimin e prodhimit.
- Situata e energjisë ndikon drejtpërsëdrejti në investimet e huaja, pasi investitorët janë dekurajuar nga pasiguria e furnizimit me energji.

Transporti, për dallim nga vetëdijesimi gjithëpërfshirës, nuk është një pengesë kryesore për momentin, ndonëse mund të bëhet nëse ekonomia e Kosovës bëhet në periudhën e afatmesme e orientuar në eksport. Me përjashtim të disa vendeve rurale, qytetet e Kosovës dhe fshatrat janë të lidhura relativisht mirë.²¹ Është vlerësuar se rrjeti i përgjithshëm rrugor është rreth 8.500 km. Rrjeti rrugor kryesor dhe rajonal përbën rreth 25% të rrjetit, por ajo bart 60% të të gjitha udhëtimeve të makinave.²²

Megjithatë, rritja e trafikut parashikohet të shtohet si rezultat i tre faktorëve që ndiko-

20 "Vlerësimi i klimës së investimit", Memorandumi ekonomik i vendit i vitit 2004; dhe "i Kufizuar", Projekti Mbështetës Grupor dhe i Biznesit i Kosovës, USAID, muaji prill i vitit 2005.

21 Dendësia e rrugës e matur në km për një km katror është 0.18 në Kosovë, e krahasuar me 0.15 në vendet e zhvilluara, 0.15 në Azinë e Largët, 0.11 në Evropë dhe në Azinë Qendrore, 0.15 në Amerikën Latine dhe Caribbe dhe 0.08 për shtetet afrikane të Saharasë. Burimi: "Hulumtimet dhe plani zhvillimor i Kosovës", i përpiluar nga Cast Consulting, muaji janar i vitit 2005.

22 Studimi i shpenzimeve të shfrytëzuesve të rrugës, Roughton International, 2004.

jnë drejtpërsëdrejti në kërkesën për transport. Përmirësimi ekonomik dhe rritja graduale e të ardhurave mesatare, popullata e re e Kosovës dhe përhapja e vendbanimeve të pakontrolluara dhe, do të bëjnë presion substancial në kërkesën për transport në 5 deri në 10 vitet e ardhshme. Në të njëjtën kohë, Kosova mund të ballafaqohet me një rritje të madhe në tarifat e pronësisë së automjeteve. Vlerësohet se në perspektivën e afatit të mesëm vlera e trafikut në mënyrë potenciale mund të rritet dy deri në katërfish²³. Për t'iu shmangur pengesave të ardhshme, është mençuri që të përgatitet një strategji ndërvepruese e transportit me një pikëpamje të angazhimit të investimit të sektorit privat në formë të partneriteteve publike private.

Sfida më e madhe në pjesën e transportit është mirëmbajtja e rrugëve dhe integrimi në rrjetin e rrugëve rajonale. Pa një kujdes të duhur për mirëmbajtjen dhe përmirësimin në standardet e rëndomta, situata aktuale stabile e transportit mund të përmbysset në mënyrë dramatike. Për më tepër, nëse përparësitë e integritetit rajonal dhe BE-ja duhet të materializohen, rrjeti rrugor duhet të lidhet si duhet me korridoret rajonale VIII dhe X. Lidhja me Shqipërinë do të marrë kohë për t'u realizuar, pjesërisht duke u varur në përparimin e pjesës së Shqipërisë.

Sigurimi i rrjetit të gjerë rrugor të Kosovës dhe relativisht numri i madh i makinave private, bëjnë që hekurudha të mos shihet si një prioritet kryesor për transportin e njerëzve ose të mallrave në përgjithësi. Megjithatë, nëse sektori i minierave duhet të bëhet një mekanizëm i rritjes në periudhën e mesme, eksporti (dhe importi për përpunim, për shembull nga Shqipëria Veriore) i mineraleve do të nevojitet të mbështetet nga një rrjet i besueshëm hekurudhor.

Aeroporti i Prishtinës ka qenë gradualisht i modernizuar gjatë viteve të fundit, por për të arritur standardet ndërkombëtare si një aeroport civil, ai duhet të modernizohet edhe më tutje.

3.4. Mjedisi institucional

Krijimi i mjedisit institucional shpreh gjendjen në institucionet politike, ligjore, ekonomike dhe administrative në kuadër të të cilit ndërmerren investimet. Deri tani qëllimi i politikës në Kosovë ka qenë krijimi i një "krijimi i një mjedisi të favorshëm", me shpresë se investimi do të materializohet.

Përkundër progresit të fundit, Kosova ka një rrugë të gjatë për para në krijimin dhe në zbatimin e të drejtave të pronës. Një problem është mungesa e regjistrave të pronës, të cilat janë të transferuara në Serbi gjatë konfliktit dhe të cilat nuk janë në dispozicion ende. Rezultati është një mungesë e besimit në transaksionet kolaterale të biznesit. Bankat komerciale janë të kujdesshme për këtë problem kur ata marrin hua të bazuar

²³ *Politika dhe Plani i Draftit të Transportit Multimodal*, MTC - Shtylla e IV-të, Barry Hutton, muaji maj i vitit 2005

në dyanshmëri. Problem tjetër janë kapacitetet e dobëta njerëzore në gjykatat komunale, të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e kontratave dhe të drejtave të pronës. Kjo është reflektuar në akumulimin e rasteve komerciale, të cilat mesatarisht i vonojnë rastet në duar të gjykatësve për 18 muaj. KEK-u, për shembull, është duke përjetuar një kohë të vështirë, duke vendosur çështjet kontraktuese me klientët e saj rreth shkyçjes së energjisë.

Mjedisi makroekonomik në Kosovë është shumë stabil. Inflacioni është shumë i ulët, me shenja se deflacioni është duke u vendosur në kohën e fundit. Rregullat e bilanci buxhetor nuk e lejon qeverinë që të krijoj deficite buxhetore, andaj nuk ekzistojnë rreziqe lidhur me qëndrueshmërinë e borxhit. Jo stabiliteti financiar që është kryesisht rezultat i pasigurisë së kursit të këmbimit, është larguar me aplikimin e euros. Nuk ekziston asnjë rrezik i zhvlerësimit dhe fryrjes së mëpastajme të borxheve. Zotimet afatgjata fiskale janë të ulëta, ndonëse shitblerjet me marrëveshje i kanë rritur rreziqet e për ngritjen e lartësisë së borxheve të ardhshme. Bankat komerciale janë duke u sjellë në mënyrë shumë të kujdesshme, duke mos u futur në rreziqe të tepruara.

“Vlerësimi i ambientit për investime” i Bankës Botërore në vitin 2003 konstatoi se në Kosovë “mjedisi i biznesit konsiderohet relativisht i favorshëm nga NMV-të.²⁴ Sistemi i tatimit është i thjeshtë, transparent dhe nuk paraqet barrë për ndërmarrjet (një ndër më të pranueshmet në rajon). Eksportet janë pa doganë, TVSH-ja prej 15% është ndër më të ulëtat në botë, tarifa mesatare e importit prej 10 % është e ulët, derisa lirimet për mallrat kapitale dhe pjesëmarrja (kontributi) janë të gatshme. Përveç kësaj, legjislacioni themelor ekonomik ka qenë i formuluar dhe infrastruktura institucionale ka qenë e krijuar dhe po mirëmbahet. Kosova ka relativisht shirit të ulët të kuq (burokraci), kërkesa të ulëta ligjore, asnjë ligj kufizues dhe të kostos së punës, qasje të lehtë në tokë dhe relativisht korrupsion të ulët në administratën publike.

Çështja e statusit është bërë refren i bisedave politike në Kosovë, por ndikimi i statusit në ekonomi është kryer. Statusi është bërë kokë turku që mban mëkatet e çdo gjëje që ecën keq në Kosovë. Megjithatë, derisa statusi është një çështje më e vogël për investitorin vendor sesa për ata të huaj, ai nuk mundet vetvetiu të sqarojë mungesën e investimit nga banorët vendas. Tarifa e investimit është e ulët, kur merret në konsideratë ndikimi i statusit. Në mënyrë të kundërt, ne mund të imagjinojmë perspektivën e zhvillimit të Kosovës nëse statusi nuk do të ishte një problem. A do të lëshohen investimet në masë të madhe, nëse zgjidhet pasiguria e lidhur me çështjet politike dhe statusin? Pothuajse sigurisht jo! Madje, duke lejuar kohë për efektet e vendimit të tillë, suksesi do të jetë shumë i dyshimtë. Statusi është faktor por jo ndër kufizimet kryesore.

Padyshim, imazhi i Kosovës nevojitet të përmirësohet. Shumë njerëz, veçanërisht në Perëndim, Kosovën e lidhin me luftë dhe shkatërrime, dhe se besimi në stabilitetin politik ka qenë i dëmtuar pas marsit të vitit 2004. Megjithatë, mjedisi institucional është më i mirë sesa fama e saj.

²⁴ “Memorandumi Ekonomik i Kosovës”, Banka Botërore, muaji maj i vitit 2004.

Mënyra më e mirë për të përmirësuar imazhin e Kosovës është që t'i mbajë dhe të promovojë arritjet ekzistuese. Në përgjithësi, korniza institucionale ende nuk është bërë kufizim i detyrueshëm për investime, mirëpo ekziston rreziku real që ekonomia e zhvilluar mund të rrisë më shpejt rregullimin e dobët institucional. Ky mjedis institucional është i madh dhe jo i hulumtuar. Një rishikim i plotë institucional është i domosdoshëm në këtë fazë për Kosovën. Duke folur gjerësisht, sfidat më brengosëse për momentin janë: (i) papërvoja e institucioneve publike dhe dobësia e sistemeve që përforcojnë punët e tyre; dhe (ii) kapaciteti joadekuat i paraqitjes së shërbimit civil.

3.5. Promovimi i investimeve

Në shumë fusha, qeveria duhet jo vetëm të krijojë një mjedis të përshtatshëm, por duhet edhe ta stimulojë investimin përmes stimulimeve të planifikuara dhe të administruara me kujdes. Shtrohet pyetja: Cilat aktivitete duhet të mbështeten? Peshorja deri tani ka anuar nga sektorët që tradicionalisht kanë ofruar të ardhura dhe vende pune për kosovarët – bujqësia, energjia dhe xehetaria. Duke ditur tkurrjen e tyre gjatë dy dekadave të fundit, por edhe rezervat e furnizimit të shumta (të begata), atëherë potenciali për rritjen e sektorëve tradicionalë është vërtet i lartë.

Megjithatë, në rezultatet e hulumtimeve të aktiviteteve jotradicionale, qeveria ka rol esencial në promovimin aktiv të investimit. Siç është thënë më lart, nëse mbesin të pambikëqyrura, atëherë do të ketë një nëninvestim në aktivitetet jotradicionale. Aktivitetet tipike në të cilat qeveria mund të ndihmojë janë:

- Projekti kapital (venture capital - kapitali i rrezikut të lartë)
- Koordinimi i granteve
- Hulumtimi & Zhvillimi
- Zgjerimi i shërbimeve në bujqësi
- Asistenca në marketing dhe në distribuim
- Asistenca teknologjike
- Adoptimi i teknologjisë bujqësore nga vendet fqinje
- Koordinimi i investimit
- Cilësia dhe siguria e produktit
- Harmonizimi i standardeve

Përfshirja e qeverisë në aktivitetet e promovimit të investimit nuk është pa rreziqe - edhe qeveritë mund të dështojnë, ndoshta për shkak të mungesës së burimeve të mjaftueshme, apo për shkak të kapaciteteve të dobëta. Qeveria e Kosovës ka posaçërisht vështirësi të mëdha buxhetore, duke ditur edhe pamundësinë në udhëheqjen e deficiteve buxhetore. Edhe koha relativisht e shkurtër e ekzistimit të saj dhe papërvoja e shërbyesve civilë e bën posaçërisht të ndjeshme në kërkim të qirasë (ndihmës).

Aktualisht, aktivitetet për promovimin e investimit janë të parëndësishme në krahasim me shkallën e sfidës me të cilën po ballafaqohet qeveria. Ka nevojë për një mekanizëm koordinimi në qeveri, që shtyn në drejtim të krijimit të legjislacionit apo

rregullores së aktiviteteve investuese. Themelimi i një Agjensionit për Promovimin e Investimit në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, në korrik 2005, është një hap i rëndësishëm në drejtim të duhur. Tani është me rëndësi që instituti i ri të marrë rol proaktiv dhe që mjetet ekzistuese për promovimin e investimeve të përdoren me efikasitet.²⁵

Më e rëndësishmja është se duhet të bëhet dallimi midis investimeve në aktivitetet tradicionale dhe investimeve në aktivitetet jotradicionale. Deri tani, pothuajse të gjitha aktivitetet e reja kanë ndodhur në sektorin tradicional, ku kompanitë i venë çmimin njëra-tjetrës jashtë tregut.

Gjithashtu, asistenca ndërkombëtare në lëmin e promovimit të investimit duhet të fokusohet dhe të koordinohet më mirë. Shumica e intervenimeve ndodhin në mënyrën ad hoc dhe janë të orientuara nga kërkesa e donatorit. Ekziston një numër i madh i akterëve të involvuar në dhënien e asistencës teknike dhe financiare, por nuk ekziston një strategji koherente se si të kanalizohet kjo asistencë më me efikasitet. Shembuj të mirë të aktiviteteve që përmbajnë komponentin e promovimit të investimit janë projektet e USAID KCBS-it, të cilat kanë për qëllim krijimin e asociacioneve biznesore dhe përmirësimin e shërbimeve këshilluese biznesore me një rezultat të përgjithshëm të përmirësuar dhe të koordinuar më mirë.

Një element i rëndësishëm për promovimin e investimit është asistenca financiare. Aktivitetet jotradicionale në vete përmbajnë rrezik, meqë ende duhet të caktohet kostoja e tyre. Ndarja e kostove nga rezultatet e këtyre hulumtimeve është një mënyrë e promovimit të transformimit ekonomik. Huazimi nga bankat komerciale në Kosovë është afatshkurtër dhe jo i gatshëm për nisma të reja (aktivitete hulumtuese). Kërkesat shitesë janë nga 150-200% të shumës së huas. Asnjë skemë e projekteve kapitale nuk e mundëson financimin e nismave të reja. Duke ditur rrezikun e zbulimit të profitabilitetit të aktiviteteve të reja (aktiviteteve jotradicionale), nuk ekziston asnjë mekanizëm për ndarjen e rreziqeve. Nuk ekziston asnjë formë e projektit të kapitalit, e cila financimin e ideve të reja e bën të pamundshëm.

Në bujqësi, ekziston një plan për themelimin e fondit për zhvillim rural. Huat bujqësore përbëjnë vetëm 2% të totalit të kredisë në sektorin bankar komercial.²⁶ Aktivitetet mikrofinanciare janë të modeluara më tepër si skema që promovojnë kohezionin social dhe zvogëlojnë dallimet gjinore dhe etnike sesa si burime promovimi të aktiviteteve jotradicionale. Programi ABU i BE-së ofron shërbime këshilluese dhe hua për fermat komerciale. Ofron hua afatgjata deri në 5 vjet, me një shkallë interesi prej 10%. Aktualisht ka 10 milion euro nga huat e papaguara. Huamarrësit e mëparshëm nuk kanë vepruar mirë, ndonëse suksesi i programit ka mbetur të shihet akoma.

²⁵ Shembull, vetëm web-faqja e agjencionit për regjistrimin e biznesit (<http://www.arbk.org/>) që nga 10 maji 2005 kishte 135 shënime, shumica e të cilave erdhën nga autori i këtij raporti.

²⁶ Libri i Blertë i Kosovës, 2003.

4. Konkluzioni: Qëllimet dhe prioritetet e politikës

Ky dokument ka nënvizuar nevojën për transformimin struktural të ekonomisë së Kosovës. Një transformim i tillë ekonomik duhet të përforcohet nga një vizion ekonomik i përbashkët dhe të ndërmerret nga një strategji zhvillimore ekonomike. Transformimi duhet të përforcohet me rezerva (burime) dhe duhet t'i tejkalojë barrierat që i dalin në rrugë.

Zhvendosja nga produktiviteti i dobët (tradicional) në aktivitete të produktivitetit të lartë (jotradicionale) nënkupton transformimin struktural që Kosova ka nevojë ta kalojë. Ky transformim nuk do të ndodhë derisa:

- Burimet fizike dhe institucionale të jenë mobilizuara si duhet;
- Pengesat kryesore të investimit të jenë larguar; dhe
- E tërë korniza e politikës (rregullores) të jetë e orientuar drejt përmbushjes së qëllimit të transformimit.

Shumë burime do të zhblllokohen nëse sektorët tradicionalë të energjisë dhe të minierave janë ringjallur duke kursyer. Duke i përdorur këto burime për të zhvilluar aktivitete të produktivitetit më të lartë, Kosova do të jetë në gjendje të mbajë një nivel më të lartë të aktivitetit ekonomik dhe standardit jetësor.

Barrierat më të mëdha momentalisht janë kualiteti i arsimimit, furnizimi jo i mjaftueshëm me rrymë, si dhe mungesa e aktiviteteve promovuese të investimit. Qeveria duhet t'i tejkalojë me guxim këto barrierë, me intervenime të shënjuara si duhet. Në veçanti, promovimi sistematik i investimit duhet të vihet në krye të listës së prioritetëve të qeverisë. Në këtë stad, zhvillimi i një strategjie kuptimplote zhvillimore të sektorit privat, duke u mbështetur në rishikimet e instrumenteve dhe burimeve në dispozicion, është esencial për shfrytëzimin e frymës biznesore (sipërmarrëse) të popullit të Kosovës.

Të gjitha strategjitë dhe politikat e sektorëve duhet të udhëhiqen nga vizioni i transformimit struktural. Sot është fare e rëndomtë të anashkalosh faktin se politikat janë instrumente që mund të përdoren për të fituar rezultate të ndryshme ekonomike. Në shumë raste, hartuesit e politikave jepen pas politikave standarde pa i parashtruar vetes pyetjen: çfarë dua unë përfundimisht të arrij me këtë politikë? Për shembull, qëllimi

i zhvillimit të sektorit të mirëfilltë financiar është virtualisht për se, por sapo të sigurohet mirëqenia e tij, atëherë duhet të mendohet roli që mund të luajë ai në transformimin struktural.

Paragrafi në vazhdim radhit sektorët kryesorë të politikës dhe jep një plan se si ato mund ta mbështesin transformimin ekonomik të Kosovës. Prioritarizimi dhe ndarja duhet të ndërmerren gjatë hartimit të strategjisë së zhvillimit ekonomik.

A - PËRMIRËSIMI I MJEDISIT

Qëllimi i përgjithshëm: Për të garantuar sigurinë e qytetarëve dhe pasurinë e tyre, duke e avancuar sundimin e ligjit, si dhe efikasitetin e shërbimit civil.

- Legjislacioni – Përfundoni kornizën esenciale legjislative. Përshtatni kornizën legjislative, duke ia adoptuar atë rrethanave vendore. Koordinohuni gjatë procesit të formulimit të legjislacionit.

- Përforsimi i ligjit – Siguroni paprekshmërinë e të drejtave mbi pasurinë, duke konsoliduar gjykatat dhe policinë, duke përforsuar të drejtat mbi pasurinë, duke i përmirësuar dhe përforsuar kontratat, si dhe duke hulumtuar mekanizmat tjerë të arbitrit.

- Institucionet publike – përforsoni kapacitetin e institucioneve publike që të ballafaqohen me rritjen e kërkesave të një ekonomie në zgjerim e sipër, si dhe krijoni shërbime civile të cilësisë së lartë që lehtësojnë bashkëveprimin e qeverisë me sektorin privat.

- Politika e tatimit – Krijoni burime adekuate për mirëmbajtjen e shërbimeve civile, infrastrukturës fizike dhe institucionale, si dhe shërbimeve publike, pa u bërë barrierë e zhvillimit të sektorit privat. Sa i përket konkurrencës së tatimeve me vendet fqinje, hartoni politikën e tatimeve që i jep Kosovës një vend konkurrues në rajon.

- Politika e shpenzimeve – Caktoni burime për aktivitetet që sjellin të ardhura më të mëdha. Përqendroni burimet në fushat ku barrierat e transformimit janë më të larta (mungesa e promovimit të investimit, arsimimi i dobët, furnizimi joadekuat më energji elektrike).

- Administrata dhe financat publike – Siguroni ndershmëri dhe efikasitet në financat publike.

B - SEKTORI PRIVAT DHE PROMOVIMI I INVESTIMIT

Qëllimi i përgjithshëm: të arrihet transformimi struktural i ekonomisë nga një ekonomi e bazuar në bujqësi në një ekonomi të bazuar në prodhim dhe shërbime, si dhe të zhvendosen aktivitetet nga fushat e produktivitetit të ulët në ato me produktivitet më të lartë.

- Privatizimi – Përdorni një proces të përforcuar dhe të përshpejtuar të privatizimit, për të përforcuar sektorët e energjisë dhe të minierave në veçanti, si dhe sektorët produktivë në përgjithësi. Përdorni privatizimin që t'i zhblokon burimet dhe asetet, të cilat mund të përdoren më mirë në sektorin privat.

-

- Minierat – Përfordoni xehetarinë përmes një procesi efektiv të privatizimit, i cili do të trasojë rrugën për eksportet e mirëfillta dhe fitimin e valutës së huaj.

- Bujqësia – Analizoni potencialin e fitimeve nga produktiviteti i sektorit të bujqësisë, duke i inkurajuar bujqit që të përmirësojnë efikasitetin e praktikës së tyre momentale, si dhe duke ndërmarrë ide të reja investuese. Mbështetni konsolidimin e tokës, duke përmirësuar efikasitetin e tregut të tokës përmes përfordimit të të drejtave mbi pasurinë dhe kontratave.

- Politika e tregtisë – Hartoni tutje një politikë të tregtisë, e cila, në një anë, nuk i dëmton konsumatorët, ndërsa, në anën tjetër, inkurajon zhvillimin e një sektori të shëndoshë privat. Përdorni politikën e tregtisë që të ofroni stimulime drejt daljes nga aktivitetet tradicionale dhe që të joshni FDI-në.

- Sektori financiar – Bëni sektorin financiar gurthemel të zhvillimit të sektorit privat. Ruajeni nga rrezikimet tej mase dhe, në ndërkohë, promovoni instrumente që të mundësoni financimin e projekteve vitale që sjellin të ardhura të mëdha.

- Promovimi i investimit – Krijoni një sektor të shëndoshë privat me aktivitete të ndryshme që nxisin rritjen në një periudhë afatgjatë, duke promovuar investimin në sektorin privat në përgjithësi, si dhe duke vënë në prioritet investimin e aktiviteteve jotradicionale përmes stimulimeve të shënuara me kujdes, si dhe përmes mbështetjes institucionale.

- Politika e tatimeve – Ofroni stimulime adekuate për zhvillimin e sektorit privat.

C - ZHVILLIMI I BURIMEVE NJERËZORE

Qëllimi i përgjithshëm: Ta përmirësoni bazën e burimeve njerëzore, që t'i përgjigjet kërkesave për shkathtësi në sektorin privat dhe në administratën publike.

- **Arsimimi** – Përmirësoni (i) infrastrukturën e sistemit arsimor (numrin dhe kushtet fizike në shkolla, kopshte fëmijësh etj.); dhe (ii) cilësinë e arsimimit (tekstet, cilësinë e mësuesit, planprogramet, etj.). Kuptoni perspektivat e rritjes dhe observoni nga afër tregun e punës për sinjalet e kërkesës për shkathtësi dhe kualifikime të caktuara dhe veproni shpejt që të stimuloni furnizimin e tyre.

- **Politika sociale** – Ofroni rrjete sigurie për mbështetjen e të pafavorshmëve në procesin e transformimit të ekonomisë, e cila do të shpie në dislokimin e fuqisë punëtore.

D - ZHVILLIMI I INFRASTRUKTURËS

Qëllimi i përgjithshëm: Të përshpejtohet rritja në një periudhë afatmesme, si dhe të mbështetet transformimi struktural në një periudhë afatgjatë.

- **Energjia** – Përmirësoni sektorin e energjisë që të: (i) përmirësojë sigurinë me furnizim elektrik në mbështetje të zhvillimit të sektorit privat; dhe (ii) eksportoni energjinë në tregun rajonal, për të grumbulluar të hyra të konsiderueshme.

- **Transporti** – Mirëmbani dhe përmirësoni rrugët, që t'i përgjigjeni me efikasitet kërkesës së sektorit privat. Përmirësoni lidhjet me korridoret transportuese rajonale, me qëllim të shfrytëzimit të mundësive të tregtisë.

VEPRIMTARIA BOTUESE

Që nga viti 1996 Riinvesti ka botuar një numër të konsiderueshëm të publikimeve që përfshihen në listën e mëposhtme:

1. M. Mustafa, E. Kutllovci, P. Gashi, B. Krasniqi: Biznesi i Vogël dhe i Mesëm, 2006
2. Qëndrueshmëria Ekonomike e Kosovës (Sfidat, Politikat dhe Mundësitë, 2006)
3. Profili Socio-Ekonomik i Kosovës dhe Sfidat e Zhvillimit, 2005
4. Dr.Isa Mustafa: Menaxhmenti Financiar, 2005
5. Privatizimi në Kosovë: Përparime dhe ngecje, 2005
6. Zhvillimi Ekonomik Lokal dhe Investimet e Jashtme Direkte, 2004
7. Zhvillimi Rural në Kosovë, 2004
8. Sistemi i arsimit dhe zhvillimi ekonomik i Kosovës, 2004
9. Zhvillimi i NVM-ve në Kosovë: Raport vjetor- 2003, 2004
10. Politikat Tregtare dhe Promovimi i Eksportit në Kosovë, 2003
11. Dr.Muhamet Mustafa: Menaxhmenti i Projekteve Investive, botimi i tretë, 2004
12. Dr.Isa Mustafa: Lidershipi, 2004
13. Sistemi Buxhetor i Kosovës-Politikat dhe Qëndrueshmëria, 2003
14. Tryezat e diskutimit: Ecuritë në Ndërtimin e Politikës së Tatimeve dhe të Taksave dhe Financimit të NVM-ve në Kosovë,2003
15. Zhvillimi i NVM-ve në Kosovë (Raport vjetor – 2002), 2003
16. Korrupsioni dhe ndikimi i tij në ekonominë e Kosovës, 2003
17. Tregu i punës dhe papunësia në Kosovë, 2003
18. Dr.Ymer Havolli: Menaxhmenti i resurseve njerëzore, 2003
19. Prof.Dr.Ibrahim Kuka: Vendosja afariste, 2003
20. Investimet e jashtme direkte në Kosovë, 2002
21. Privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore dhe reforma e ndërmarrjeve publike në Kosovë, 2002
22. Aspektet kyçe të situatës sociale dhe ndërtimi i sistemit të pensioneve në Kosovë, 2002
23. Zhvillimi i NVM-ve në Kosovë-2001 (Raport Vjetor 2001), 2002
24. Zhvillimi Ekonomik Lokal, 2002
25. Privatizimi i Ndërmarrjeve Shoqërore dhe Reforma e Ndërmarrjeve Publike në Kosovë, 2002

26. Direktoriumi i financimit të biznesit në Kosovë, 2002
27. Zhvillimi i NVM-ve në Kosovë-200 (Raport vjetor 2000) 2001
28. "Financimi I NVM-ve, një pasqyrë regjionale"
29. Financimi dhe zhvillimi i NVM-ve në Kosovë, 2001
30. Disa çështje kyçe të ndërtimit dhe të zbatimit të politikës fiskale në Kosovë, 2001.
31. "Ndërmarrjet Shoqërore dhe Transformimi/Privatizimi i Tyre", 2001.
32. Rindërtimi i Kosovës pas Luftës – Strategjia dhe Politikat, 2001
33. Pasojat e Luftës dhe Riaktivizimi i 193 Ndërmarrjeve Shoqërore, 2000
34. "Ndërmarrjet Shoqërore dhe Privatizimi i Tyre", 2001
35. Rindërtimi i Kosovës pas Luftës (Strategjia dhe politikat), 2001.
36. Pasojat e Luftës dhe Zhvillimi i NVM-ve, 2000.
37. Pasojat e Luftës dhe Zhvillimi i NVM-ve, 1999
38. Pasojat e Luftës në Ekonomitë dhe Bizneset Familjare, 1999
39. Grup Autorësh: Ndërtimi dhe Funksionimi i Institucioneve të Administrimit Lokal në Kosovë, 2000
40. Ripërtëritja dhe Rindërtimi i Kosovës pas Luftës. 1999
41. Strategjia e Zhvillimit Ekonomik dhe Gjenerimi i NVM-ve.1999
42. Sistemi i Ekonomisë së Hapur dhe Tranzicioni në Kosovë. 1998
43. Dr. Nexhmi Rexha & Dr. Nail Reshidi: Bazat e Marketingut. 1998
44. Dr. Ibrahim Kuka: Vendosja Afariste. 1998
45. Grup autorësh: Aktivitetet Ekonomike dhe Zhvillimi Demokratik i Kosovës, 1998
46. Dr. Fadil Govori: Tregu Financiar. 1998
47. Dr. Muhamet Sadiku: Sistemi Ekonomik dhe Zhvillimi i Kosovës. 1998
48. Dr. Muhamet Mustafa: Menaxhmenti i Projekteve Investive,1998
49. Dr. Fadil Govori: Mobilizimi i Kursimeve të Diasporës Kosovare. 1998
50. Dr. Nail Reshidi: Kërkimet e Tregut. 1997
51. Dr. Nail Reshidi: Promovimi. 1997
52. Grup Autorësh: Biznesi, Problemet dhe Perspektivat. 1996
53. Dr. Nexhmi Rexha: Fjalor Anglisht – Shqip dhe Shqip – Anglisht i termave të Marketingut. 1996

